



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **KUVENDI I KOMUNËS**

**Procesverbal nga mbledhja e III-të (tretë) -e rregullt, mandati VIII-të, e mbajtur më 29 janar 2026.**

Mbledhja filloi në orën 10:20 dhe u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës.

Fillimisht mbledhjen e hapi dhe kryesoi z.Isak Shabani Kryesues i Kuvendit të Komunës së Podujevës.

Në mbledhje të pranishëm ishin anëtarët/et e Kuvendit të Komunës së Podujevës:

Nga LVV, Adelinë Stublla; Artrit Mulliqi; Fatri Zhitija; Kasib Bashota; Florent Hasani; Valdet Kamerolli; Arbrim Konushevc; Flandra Kadriu; Luljeta Muçolli-Azemi; Vlora Jashanica; Abedin Zeka; Avni Islami; Qëndresë Hajrizi; Ardi Hasani, kurse mungoi Haki Rudari

Nga LDK, Enis Shabani; Alisa Jetullahu; Enis Dërvisholli; Besim Latifi; Blerta Azemi-Berisha; Valon Demolli; Ekrem Rrahmani; Ermal Osmani; Gresa Qosa-Maqastena; Arben Xhemajli; Arnisa Sylejmani; Isak Ejupi, kurse mungoi Valdet Restelica

Nga PDK, Isak Shabani-Kryesues i Kuvendit; Lulzim Pollomi; Mimoza Abdullahu; Rinesa Goxhufi,

Nga GUXO, Demokrat Hodolli.

Nga Unioni i Blakçorve, Gentrif Arifi.

Nga AAK, Baki Feta.

Gjithashtu të pranishëm nga Ekzekutivi i Komunës ishin, z.Fahri Restelica Nënkyetar i Komunës, drejtorët e Drejtorive të Komunës, dhe atë;

(Avni Fetahu-Drejtorja e Arsimit DKA; Lirie Hoti Rama-Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale DSHMS; Saranda Stublla-Drejtorja e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë DPKGJ; Bahri Selimi-Drejtorja e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit DSHPMSH dhe i Autorizuar për kryerjen e funksioneve të Drejtorive tjera për të cilat ende nuk janë emëruar drejtorët/shat; Shuajb Blakçori-Drejtorja e Inspeksionit DI; Behram Latifi-Drejtorja e Bujqësisë Pylttarisë dhe Zhvillimit Rural DBPZHR; Vigan Salihu-Drejtorja e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik DPZHE)

Të pranishëm ishin edhe, përfaqësues media lokale (TV Llapi), përfaqësues të KFOR; përfaqësuesi i OSBE-së z.Samir Calakoviç, dhe disa zyrtar komunal.

### **Rendi i Ditës**

**z.Isak Shabani, Kryesues i Kuvendit**, e hapi mbledhjen duke përshëndetur dhe duke i'u uruar mirëseardhje të pranishmëve, theksoi, po fillojmë me mbledhjen e tretë të mandatit të VIII-të të Kuvendit të Komunës së Podujevës, prandaj ju uroj mirëseardhje dhe punë të mbarë.

Paraprakisht dua t'ju njoftoj se dy këshilltarë të Kuvendit kan paralajmëruar se nuk do të jenë pjesë e kësaj mbledhje dhe atë për arsye se këshilltari z.Haki Rudari gjendet jashtë shtetit, kurse z.Valdet Restelica i cili ka pasë një intervenim të vogël kirurgjik në tetivin e akilit dhe ka lajmëruar se nuk do të mund të jetë pjesëmarrës në mbledhje, për çka unë në emrin tim personal dhe në emër tuajin i dëshiroj shërim të shpejtë dhe që sa më parë të jetë në gjendje të bashkohet punimeve të Kuvendit.

Në bazë të nënshkrimeve në listën përkatëse të këshilltarëve dhe në bazë të numërimit, 33 këshilltarë/e të Kuvendit janë prezent në sallë që do të thotë se kuorum ka dhe mund të fillojmë me punime të kësaj seance sipas thirrjes.

Të nderuar besoj se edhe materiali i kësaj mbledhje ju është përcjellë me kohë dhe e keni pranuar të gjithë, gjithashtu ju njoftoj se dje e kemi mbajtur edhe mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa ku pothuajse Njësëri i janë rekomanduar Kuvendit shqyrtimi i këtyre pikave të rendit të ditës për këtë mbledhje, andaj para se të hedh në votim rendin e propozuar të ditës, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën rreth rendit të ditës, nëse jo atëherë fillimisht po i lexoj pikat e rendit të ditës dhe pastaj e hedh në votim. *(lexon pikat e rendit të ditës sipas thirrjes së mbledhjes)*

*Pas votimit u konstatua se Njësëri me 33 vota Për nga anëtarët/et e Kuvendit sa ishin prezent, miratohet rendi i propozuar i ditës sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes, përfshirë edhe Konstatimet e rekomanduara nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur një ditë më parë.*

#### Rendi i miratuar i ditës:

1. Procesverbali nga mbledhja e Kuvendit të Komunës, mbajtur më 29 dhjetor 2025
2. Raporti përmbledhës i punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2025
3. Propozim vendimi për formimin e Komisionit Ad-Hoc për hartimin e draft Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2026
4. Propozim vendimi për themelimin dhe përbërjen e Komitetit për Komunitete
5. Propozim vendimi për ngritjen e komisionit për përzgjedhjen e drejtorëve/shave dhe zëvendës drejtorëve/shave në institucionet publike edukativo arsimore të Komunës së Podujevës
6. Propozim vendimi për miratimin e Listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2026
7. Të ndryshme

### **1. Procesverbali nga mbledhja e Kuvendit të Komunës, mbajtur më 29 dhjetor 2025**

**z.Isak Shabani, Kryesues i Kuvendit**, theksoi, besoj të gjithë e keni marrë me kohë materialin e kësaj pike të rendit të ditës, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e hedh në votim këtë Procesverbal që të miratohet sipas materialit përkatës.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njësëri me 33 vota Për, nga anëtarët/et e Kuvendit sa ishin prezent, miratohet pa vërejtje apo plotësim ndryshime Procesverbali nga mbledhja e Kuvendit të Komunës, mbajtur më 29 dhjetor 2025, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.*

### **2. Raporti përmbledhës i punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2025**

**z.Isak Shabani, Kryesues i Kuvendit**, theksoi, sigurisht të gjithë keni mund ta lexoni dhe analizoni këtë raport i cili është përmbledhje e punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2025, andaj e hapi debatin për këtë raport.

**znj.Adalina Stublla**, theksoi, në emër të Grupit të LVV-së e përkrahim dhe mbështetim këtë Raport të punës së Kuvendit, por me disa vërejtje që sa i përket këtij raporti për vitin 2025 dhe praktikave tjera të kaluara, drejtorët e Drejtorive të bëjnë raportimet në bazë të planit të punës.

**z.Ekrem Rrahmani**, theksoi, kërkova fjalën duke pas parasysh se kam qenë anëtar i Kuvendit edhe në mandatin e kaluar e që në muajin nëntor 2024 e kemi përgatitur Planin e punës për vitin 2025, Plan në të cilin ka pasë pika të cilat kanë kaluar dhe janë miratuar mirëpo një shqetësim e kam që gjatë vitin 2025 drejtorët e Drejtorive rrallëherë, përjashtim dy Drejtoreshave të cilat i kanë sjellë informatat në Kuvend, të tjerët asnjëherë, pra shembull kemi drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit-DSHPMSH i cili që 5 vite asnjë informatë nuk e ka sjellë në Kuvend e që e kanë për obligim dy herë në vit të sjellin informata apo raporte.

Unë e kam këtu Planin e punës së Kuvendit për vitin 2025, por për të mos hyrë me radhë, them se kemi mbi 20 pika që nuk janë realizuar, shembull kemi Planin e prokurimit i cili vetëm hyn në Planin e punës së Kuvendit dhe asnjëherë nuk sjellët, pastaj Informatat e drejtorëve të Drejtorive, Raportet tremujore financiare, Raporti i Kryetarit të Komunës e që është obligim ligjor të sjellët dy herë në vit por që në vitin 2025 nuk ka raportuar asnjëherë. Ka edhe shumë pika tjera por besoj se meqë kemi edhe sot në rend të ditës propozim vendimin për formimin e komisionit për hartimin e Planit të punës së Kuvendit për vitin 2026, do të sugjeroja që drejtori i DSHMPSH i cili nëse vazhdon sërish të jetë drejtor i kësaj Drejtorie, nëse nuk jep informata në Kuvend të mos përfshihet fare në Plan të punës, kjo për shkak se në rast përfshihet në Plan të punës dhe nuk sjellët informata atëherë përse të futet në Plan.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, urdhëroni nëse ndokush tjetër dëshiron fjalën rreth këtij Raporti, nëse jo atëherë meqë nuk ka nevojë të ketë votim për raporte të tilla, e konstatojmë të përfunduar / mbyllur këtë pikë të rendit.

*Konstatohet e përfunduar kjo pikë e rendi të ditës.*

### **3. Propozim vendimi për formimin e Komisionit Ad-Hoc për hartimin e draft Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2026**

**z.Isak Shabani, Kryesues i Kuvendit**, theksoi, në radhë kemi propozim vendimin për formimin e Komisionit Ad-Hoc për hartimin e draft Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2026, pikë e cila është diskutuar edhe në mbledhjen e KPF-së ku jemi dakorduar të gjithë njëzëri që përbërja të jetë e këtillë, pra Kryesuesi i komisionit të jem unë nga cilësia e Kryesuesit të Kuvendit, pastaj të gjitha subjektet politike, si dhe do të jenë nga Ekzekutivi i Komunës, pra nga një propozim prej LVV-së, LDK-së, PDK-së, GUXO-së, Unionit të Blakqorve, AAK-së, mandej do të jenë edhe 4 anëtarë nga radhët e Ekzekutivit të Komunës të cilës sigurisht se do të propozohen e që mendoj se do të jenë ata të cilët kanë më shumë punë dhe që kanë më së shumti për të dhënë kontribut në hartimin e Planit të Punës së Kuvendit, ku mbi të gjitha Ekzekutivi i Komunës e ka atë detyrën e vet që mban takime paraprake dhe që koordinohen vazhdimisht andaj edhe kërkohet që të prezantohen pikat që ata mendojnë se do të trajtohen në vitin 2026. Prandaj siç e theksova, meqë kemi pas një dakordim në KPF për këtë përbërje, nëse pajtoheni ju ftoj të kalojmë me propozime.

**z.Artrit Mulliqi**, theksoi, në emër të Grupit të LVV-së e propozojmë kolegun z.Avni Islami për anëtar në këtë Komision.

**z.Valon Demolli**, theksoi, nga Grupi i LDK-së e propozojmë z.Besim Latifin.

**znj.Mimoza Abdullahu**, theksoi, nga Grupi i PDK-së e propozojmë z.Lulzim Pollomin.

**z.Demokrat Hodolli**, theksoi, unë jam përfaqësues i vetëm i Partisë Guxo në Podujevë që jam edhe anëtar i Kuvendit, nuk e di a bie në kundërshtim me ligjin nëse e propozoj vetveten.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, unë kam menduar dhe vlerësuar se është mirë që në përbërjen e Komisionit të jenë edhe përfaqësuesit e tri subjekteve që janë me nga 1 anëtar në këtë Kuvend, tani propozimet edhe mund të bëhen por ju nëse dëshironi vetëm i hedhim emrat në votim.

**z.Demokrat Hodolli**, theksoi, atëherë pra unë e propozoj z.Gentrit Arifin nga Unioni i Blakqorve që të jetë pjesë e Komisionit në fjalë.

**z.Gentrit Arifi**, theksoi, anëtar në Komision në fjalë e propozoj z.Demokrat Hodollin nga GUXO.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, atëherë mua më mbetet që ta propozoj z.Baki Feta nga AAK, mirëpo t'ju them të drejtën ndoshta harrova t'ju rikujtoj paraprakisht se kërkohet të ketë edhe barazi gjinore, unë kam pyetur Zyrën ligjore dhe më është thënë se për çdo komision, grup punues apo trup kolegji që formohet në Kuvend duhet të ketë përfaqësimin gjinorë, andaj kjo mund të anulohet nga Ministria përkatëse në rast se nuk kemi përfaqësim gjinor, prandaj ju lus që nëse ka mirëkuptim ta zgjidhim këtë çështje edhe pse kemi 3 anëtarë të tri subjekteve me nga një këshilltarë në Kuvend dhe që të gjithë janë të gjinisë mashkullore e që në fakt nuk kanë se këndë e propozojnë tjetër sepse janë nga një. Pra është një lëshim i cili ndoshta do të ishte mirë të sqaroheshim edhe në mbledhjen e KPF-së, por nëse kemi mirëkuptim mund t'i tërheqim emrat e propozuar dhe të ri propozojmë sërish.

Nga subjekti politik PDK jemi të gatshëm ta tërheqim besoj edhe pse gjithëherë po na bie t'i tërheqim kandidatët për shkak të përfaqësimit gjinor, madje edhe unë me dëshirë do të tërhiqesha por meqë jam nga cilësia e Kryesuesit të Kuvendit nuk mundem. Pra urdhëroni fillojmë nga Grupi i PDK-së të japin propozimin tjetër.

**z.Lulzim Pollomi**, theksoi, po besoj që e rrugës do ishte që dy Partitë e para të bënin një tërheqje të propozimeve dhe të propozonin emrat tjerë femra, por si do që të jetë ne e tërheqim propozimin e mëparshëm dhe e propozojmë znj.Rinesa Goxhufi për anëtare në këtë Komision.

**z.Artrit Mulliqi**, theksoi, për shkak të plotësimit të kuotës gjinore edhe ne Grupi i LVV-së në vend të kolegut z.Avni Islami e propozojmë znj.Vlora Humolli-Jashanica.

**z.Besim Latifi**, theksoi, duke e njohur logjikën ligjore besoj që Komisioni në fjalë duhet të shikohet si përbërje e plotë, jo si përfaqësues të anëtarëve të Kuvendit. Pra nëse përbërja është prej 11 anëtarëve, nga Kuvendi dhe Ekzekutivi, të gjithë duhet të jenë në proporcion gjinitë, përndryshe unë nuk kam ndonjë problem dhe tërhiqem nga propozimi, dhe nga Grupi i LDK-së e propozojmë znj.Arnisa Sylejmani për anëtare në këtë Komision.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, tani kërkojmë që të jepen propozimet nga radhët e Ekzekutivit të Komunës, dhe mundësisht të jenë dy meshkuj dy femra.

**z.Fahri Restelica, Nënkryetar i Komunës**, theksoi, nga radhët e Ekzekutivit të Komunës propozohen drejtorët/shat Bahri Selimi, Saranda Stublla-Uka, Lirie Hoti-Rama, Avni Fetahu, që të jenë në përbërjen e Komisionit në fjalë.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, do të thotë, sipas propozimeve të dhëna, tani kemi përfaqësim gjinorë sepse janë 5 femra dhe 6 meshkuj, atëherë para se t'i hedh në votim po i lexoj edhe njëherë emrat e anëtarëve të Komisionit: unë Isak Shabani; Vlora Humolli-Jashanica; Arnisa Sylejmani; Rinesa Goxhufi; Demokrat Hodolli; Gentrit Arifi; Baki Feta, nga radhët e Kuvendit të Komunës, ndërsa nga Ekzekutivi i Komunës Bahri Selimi, Saranda Stublla-Uka, Lirie Hoti-Rama, Avni Fetahu.

Tani e hedh në votim këtë propozim vendim sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes, me përbërjen e anëtarëve/eve sipas propozimeve përkatëse.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njësëri me 33 vota Për, nga anëtarët/et e Kuvendit sa ishin prezent, miratohet Propozim vendimi për formimin e Komisionit Ad-Hoc për hartimin e draft Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2026, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes, dhe përbërjen si në vijim:*

- 1. Isak Shabani, kryesues i komisionit*
- 2. Vlora Humolli-Jashanica, anëtare nga radhët e Kuvendit*
- 3. Arnisa Sylejmani, anëtare nga radhët e Kuvendit*
- 4. Rinesa Goxhufi, anëtare nga radhët e Kuvendit*
- 5. Demokrat Hodolli, anëtar nga radhët e Kuvendit*
- 6. Gentrif Arifi, anëtar nga radhët e Kuvendit*
- 7. Baki Feta, anëtar nga radhët e Kuvendit*
- 8. Bahri Selimi, anëtar nga radhët e Ekzekutivit*
- 9. Lirie Hoti-Rama, anëtare nga radhët e Ekzekutivit*
- 10. Avni Fetahu, anëtar nga radhët e Ekzekutivit*
- 11. Saranda Stublla - Uka, anëtare nga radhët e Ekzekutivit*

**Kryesuesi i Kuvendit**, rreth punës së këtij Komisioni dha sqarime shitesë duke theksuar se ashtu siç e keni parë edhe në bazë të këtij vendimi pritet të ketë edhe konsultime publike dhe çështje tjera nga fusha e përgatitjes dhe hartimit të dokumenteve.

Sapo të kthehet nga Ministria përkatëse që ky vendim është i ligjshëm unë si Kryesues i Kuvendit do ta shpallë në faqen zyrtare dhe do të fillojmë me procedurat e hartimit ku sigurisht që kam menduar ta organizojmë edhe një punëtori, si dhe jashtë kësaj përbërje të këtij Komisioni që sapo u miratua, unë do të konsultohem që të kemi edhe staf mbështetës, qoftë edhe për Grupet dhe subjektet politike në mënyrë që gjithsecili të angazhohet dhe t'i hapen mundësitë që të paktën nga një staf mbështetës ta kenë të caktuar si mbështetës të tij sepse vërtetë jemi të interesuar ta kemi një Plan të punës i cili do të jetë edhe i realizueshëm, prandaj kjo po mbetet të shikojmë në të ardhme se po mundemi ta organizojmë. Pra vendimi dhe përbërja përkatëse u konstatua si i miratuar dhe vazhdojmë tutje.

#### **4. Propozim vendimi për themelimin dhe përbërjen e Komitetit për Komunitete**

**z.Isak Shabani, Kryesues i Kuvendit**, theksoi, në bazë të Udhëzimit Administrativ përkatës, përbërja e Komitetit për Komunitete është 9 anëtarë/e, 5 prej tyre nga Komuniteti jo shumicë (entitetet që jetojnë në Komunën tonë), ku neve na janë sjellë disa propozime, andaj para se të fillojmë me propozimet e sjella nga Komunitetet jo shumicë, ju njoftoj se para kësaj ka qenë njoftimi publik për paraqitjen e propozimeve me të dhënat përkatëse. Janë sjellë propozimet në mënyrë zyrtare dhe me protokoll.

Pra kemi një numër të madh të propozimeve dhe do të votojmë për secilin veç e veç, në fakt ne kishim një takim paraprakisht edhe me Grupet e këshilltarëve të Kuvendit mirëpo na mungoi Grupi i LVV-së, nuk e di përse, ku arsyeja ishte që të kemi një konsultim rreth përbërjes, emrave dhe propozimeve për anëtar/e të Komisioneve dhe të marrim një vendim apo qëndrim të prerë, por si do që të jetë ne tani jemi në dijeni se 4 anëtar/e do të jenë përfaqësues nga përbërja e Kuvendit, ndërsa 5 anëtarë përfaqësues të Komuniteteve jo shumicë që jetojnë në Komunën e Podujevës.

Urdhëroni e hap debatin rreth përbërjes, ndarjes së vendeve, numrit të anëtarëve nga Kuvendit dhe subjektet politike si dhe çështje tjera rreth formimit të këtij Komiteti.

**znj. Adelina Stublla**, theksoi, ne Grupi i LVV-së propozojmë emrat për anëtarë/e në Komitetin për Komunitete, Flandra Kadriun, Demokrat Hodollin dhe Ardi Hasanin.

**z. Besim Latifi**, theksoi, unë besoj që fillimisht përbërja e këtij Komiteti para se të jetë dëshirore është ligjore, kemi Ligjin për vetëqeverisje lokale neni 53 i cili e përcakton Komitetin për Komunitete, pastaj është Udhëzimi Administrativ për procedurën e themelimit dhe përbërjen e Komiteteve të përhershme që është Komiteti për Politikë dhe Financa, dhe Komiteti për Komunitete, dhe këto dy Komitete të përhershme të Kuvendit zgjedhën me të njëjtën formulë dhe pasqyrojnë para së gjithash raportin e forcave të partive politike në Kuvend, andaj a mund të më tregoj dikush këtu cila është formula ligjore që LVV me 1 asambleist më shumë po mundka t'i merr 3 anëtar në këtë Komitet kurse partive tjera t'iu mbetet 1 anëtar në këtë Komitet, përndryshe gjendja aktuale është ku 15 anëtar/e në Kuvend ka LVV, ne jemi 13, kurse në mandatin e kaluar kemi qenë ne LDK 15 anëtarë/e në Kuvend kurse ju LVV keni qenë 14 dhe kemi pas nga 1 anëtar/e në Komitet për Komunitete., prandaj i nderuar Kryesues, a ka mundësi të na sqaroni cila është baza ligjore e përbërjes së këtij Komiteti sepse mendoj që ne fillimisht duhet të dakordohemi sa i takojnë LVV-së, sa i takojnë LDK-së dhe sa i takojnë entitetit tjetër politik që është PDK, pra fillimisht duhet të dakordohemi për këtë ndarje pastaj vazhdojmë me propozimet.

Sa i përket pjesës së Komuniteteve jo shumicë mendoj se është mirë të kemi një pauzë të shkurtër rreth 15 minuta në mënyrë që të shikojmë dhe të gjejmë një dakordim për një gjithëpërfshirje të Komuniteteve jo shumicë të cilat jetojnë në Komunën e Podujevës dhe të atyre të cilët kanë konkurruar për të qenë pjesë e këtij Komiteti.

**z. Ekrem Rrahmani**, theksoi, edhe unë dua një sqarim sepse te neni 53 i Ligjit për vetëqeverisje lokale, pra pika 1.3 e këtij neni thotë që Komiteti për Komunitete përfshinë në radhët e veta shumicën e thjesht nga anëtarët e Kuvendit të Komunës, anëtarët tjerë janë përfaqësues të komuniteteve, pra do të thotë që këtu ligji po e kërkon që shumica e thjesht e këtij Komiteti duhet të jenë anëtar të Kuvendit e shumica e thjesht i bie që duhet të jenë 5 anëtarë/e prej Kuvendit, nuk po e di përse është ndërruar tani dhe propozohet të jenë 5 anëtar nga Komunitetet kurse 4 nga Kuvendi, unë e kuptoj kështu këtë nen dhe do të doja të më sqarohet nga kushdo që e kupton ndryshe, pra po e lexoj edhe njëherë; Komiteti për Komunitete përfshinë në radhët e veta shumicën e thjeshtë nga anëtarët e Kuvendit të Komunës, anëtarët tjerë janë përfaqësues të Komuniteteve, pra e që në këtë rast i bie se nëse është me 9 anëtar duhet të jenë 5 anëtar/e të Kuvendit kurse 4 anëtar/e të Komuniteteve jo shumicë. Pra do të doja edhe prej Zyrës ligjore, ose të marrim një pauzë dhe të shqyrtohet kjo mundësi përse ky nen e thotë ashtu kurse ne bëjmë të kundërtën.

**z. Fatri Zhitija**, theksoi, i nderuar Kryesues do të ishte mirë të pyeten edhe Grupet tjera se a kan propozime, mund të ndodh që ndonjë prej tyre të mos ketë propozim apo që nuk dërgon përfaqësues të tyre në Komitetin për Komunitete, mandej të shohim sa propozime kemi gjithsejtë.

**z. Besim Latifi**, theksoi, i nderuar Kryesues i Kuvendit edhe njëherë po dua ta përsërisë atë që e thash se para se të jetë dëshirore duhet të jetë ligjore, ne po kërkojmë shumë qartë dhe para propozimeve po duam të dimë cila është baza ligjore dhe cila është formula për ndarjen e këtyre vendeve. Unë e kuptoj këtë tendencë për të kapur çdo komision dhe çdo gjë çka bëhet këtu që pushteti ta kapë por nuk është e mundur ajo sepse ky vend funksionon me ligje dhe me rregulla, pra nuk mund ta kapni, pavarësisht dëshirave nuk mund ta kapni, nuk është kjo punë dëshirash por është çështje ligjore, prandaj të përcaktohet qartë numri i vendeve sa i takon secilit entitet politik dhe vazhdojmë tutje me propozime, është kaq e thjesht.

**z. Ekrem Rrahmani**, theksoi, unë e kam dokumentin se qysh ndahen vendet e që mund ta dërgoj i nderuar Kryesues ose edhe mund ta lexoj tani, por të bëhet një pauzë dhe pastaj besoj se sqarohemi ngase nuk e besoj që është e arsyeshme të dal këtu në foltore dhe të bëjë pjesëtime e shumëzime,

mirëpo që dëshiron unë mund t'ju tregoj sakt në pika të shkurtra se qysh ndahen vendet, shembull, në këtë rast është LVV me 15 anëtarë e që pjesëtuar me 35 x 8, koeficienti është 1.71; tek LDK është 1.48, tek PDK del 0.45, dhe raporti i fundit me krejt këto pjesëtime e shumëzime i bie 2 me 2, mirëpo votat i keni dhe mund të vendosni qysh të doni, por MAPL është dhe vazhdojmë.

**z.Fatri Zhitija**, theksoi, unë për atë arsye e potencova që të priten edhe Grupe tjera sepse ndoshta nuk kanë propozim fare, konkretisht Grupi i PDK-së mund të mos ketë propozim fare për përfaqësim të tyre në këtë Komitet andaj për këtë arsye e ceka që të pyeten të gjithë.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, ju pyes a jeni për pauzë apo të vazhdojmë tutje, përndryshe ju them se për çdo paqartësi eventuale, është Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal që e sqaron.

**znj.Adelina Stublla**, theksoi, i nderuar Kryesues unë nuk po e shohë të arsyeshme që të ketë pauzë, gjithsecili subjekt i propozon emrat, hedhet në votim, kalon ose jo dhe kaq.

**z.Valon Demolli**, theksoi, për ndarjen e vendeve në Komitetin për Komunitete është një bazë ligjore, pastaj çështja tjetër është se formula nga Kuvendi i Komunës është 2 me 2, pra o po vazhdojmë 2 LVV, 2 LDK, ose ne si Grup i LDK nuk propozojmë fare dhe pastaj MAPL sërish e kthen këtë vendim ashtu siç ka ndodh në legjislaturën e kaluar sepse nuk mund të propozon dikush tjetër kur i takon LDK-së. Do të thotë se në këtë Komitet 2 anëtar i takojnë LVV-së dhe 2 LDK-së.

**z.Fatri Zhitija**, theksoi, askush nuk po i'a cenon Grupit të LDK-së që t'i propozoj 2 anëtar/e, pra mund t'i propozoj, kurse ne po i presim edhe të tjerët.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, vetëm një sqarim, Komiteti për Komunitete kemi paraparë që të përbëhet prej 9 anëtarëve, 5 nga Komunitetet jo shumicë dhe 4 nga Kuvendi i Komunës, pra nuk përbëhet prej 11 anëtarëve siç u cek. Meqë Grupi më i madh në këtë Kuvend nuk po tërhiqet nga propozimet dhe nuk po dëshiron pauzë, atëherë vazhdojmë me propozime, apo nëse nuk ka propozime atëherë e vazhdojmë sipas formës që kemi dhe pastaj është MAPL ajo që e përcakton se a është apo jo i ligjshëm ky vendim.

**z.Besim Latifi**, theksoi, i nderuar Kryesues i Kuvendit, besoj që seancat e Kuvendit udhëhiqen me Rregullore dhe nëse është kështu unë në emër të Grupit të LDK-së e kisha një kërkesë shumë të thjeshtë, tregona cila është baza ligjore e përbërjes së këtij Komiteti, sa me sa janë ndarjet dhe cila është baza ligjore e ndarjes së vendeve, është kaq e thjeshtë, të mos bëjmë lojëra fjalësh dhe të mos bëjmë lëvizje të tilla të panevojshme sepse pati persona të propozuar e të cilët nuk janë entitet politik fare, pastaj nuk mund të propozoj një grup për një grup tjetër sepse në emër të grupit propozon vetëm për grupin e vet.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, sipas Rregullores së punës për çdo propozim për pauzë votohet.

T'ju them të drejtën unë e kam lexuar Udhëzimin Administrativ për themelimin, përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve të përhershme dhe Komiteteve tjera në Komunë ku për Komitetin për Politikë dhe Financa e precizon shumë çartë kurse për Komitetin për Komunitete nuk e precizon çartë, do të thotë që e lë një mundësi që të vendos edhe Kuvendi i Komunës, përndryshe unë e hedh në votim propozimin për pauzë të shkurtër ashtu siç u kërkua dhe të shohim se a ka ndonjë bazë ligjore që kjo të ndryshoj dhe që pas 15 minutave të kthehemi në seancë dhe të vazhdojmë me punë, pra ta mbajmë një pauzë të shkurtër sepse mbi të gjitha jemi të interesuar që të kemi një dakordim në mënyrë që të mos vie puna që të mos kemi dallime.

*Meqë nga 33 anëtarë/e të Kuvendit sa ishin prezent, 14 ishin Për, 16 Kundër, 3 vota të Përmbajtura, Kryesuesi i Kuvendit Konstatoi se nuk kalon propozimi për pauzë të shkurtër 15 minuta e kërkuar nga z.Besim Latifi në emër të Grupit të LDK-së.*

**Kryesuesi i Kuvendit**, vazhdoi, atëherë vazhdojmë me punë, pra deri tani kemi znj.Adelina Stublla e cila i propozoj tre anëtarë/e, urdhëroni a ka propozime tjera.

**z.Besim Latifi**, theksoi, ashtu siç e prononcova në fillim, në Grupin e LDK-së nuk kemi anëtar për këtë Komitet përderisa nuk është e definuar çartë numri i anëtarëve i cili reflekton raportin e forcave në këtë Kuvend, andaj i nderuar Kryesues nuk do t'ju preferoja ta kaloni këtë pikë në votim për shkak se është një tendencë e hapur për ta kapur këtë Komitet dhe nuk është ligjore kjo sepse është e njëjta analogji dhe logjikë e përbërjes së Komiteteve të përhershme, ashtu qysh zgjedhet Komiteti për Politikë dhe Financa është e njëjta formulë në bazë të reflektimit të forcave në Kuvend, përndryshe nëse ka ndonjë formulë tjetër unë edhe njëherë po kërkojë prej anëtarëve të Kuvendit dhe prej teje si Kryesues i Kuvendit që nëse ka ndonjë formulë tjetër ligjore urdhëroni propozojeni dhe mund të vëni emra këtu pa numër, mirëpo numrat e përcaktuar janë në rregullore dhe në ligj se sa vende i ka Kuvendi dhe aty duhet të reflektoj raporti i forcave politike në Kuvend.

**Kryesuesi i Kuvendit**, vazhdoi, unë këtu përpara e kam Udhëzimin Administrativ përkatës i cili tek KPF e sqaron shumë çartë se Kuvendi i Komunës i cili përbëhet prej 35 deri në 41 anëtarë të Kuvendit të Komunës, KPF duhet të ketë jo më shumë se 9 anëtarë, andaj duke u bazuar edhe në këtë kemi shkuar edhe për Komitetin për Komunitete sepse aty nuk precizohet sa është numri i përbërjes do të thotë kemi shkuar me 9 anëtarë gjithsej, prej tyre 5 anëtar/e nga Komunitetet jo shumicë dhe 4 nga Kuvendi i Komunës. Unë në emër të Grupit të PDK-së e them se nuk kemi kandidat për anëtar në Komitetin për Komunitete, kështu që 3 emra janë propozuar dhe ka mbet edhe një emër për t'u propozuar, nëse dëshironi i nderuar z.Besim Latifi mund të jepni propozimin.

**z.Besim Latifi**, theksoi, unë ju tregova që përderisa nuk ka definim të vendeve nuk kemi propozim. Udhëzimi Administrativ i cekur duhet të merret si tërësi ashtu sikurse edhe ligji, në Udhëzimin përkatës nëni 3 e specifikon ku thuhet Kuvendi i Komunës merr vendim për themelimin e Komiteteve të përhershme, Kuvendi i Komunës themelon Komitetin për Politikë dhe Financa dhe Komitetin për Komunitete si Komitete të përhershme, dhe tani cila është logjika, unë vetëm këtë po e kërkoj, logjikën ligjore të ndarjes së vendeve, prandaj nuk kemi propozim derisa të sqarohet ligjërisht cila është formula dhe logjika ligjore e ndarjes së vendeve.

**Kryesuesi i Kuvendit**, vazhdoi, tani janë duke u ballafaquar dy mendime, njëra është se me çfarë formule e që decidiv nuk shkruan askund se sa dhe kush e përbën këtë Komitet përveç asaj që e dëgjuam deri tani, të paktën unë nuk e kam gjet askund ku për Komitetin për Komunitete shkruan sakt sa është përbërja përveç numrit prej 9 anëtarëve që kemi shkuar sikurse në KPF, pra propozimi është të shkohet me 3 anëtarët e propozuar dhe nëse Grupin e LDK-së nuk keni propozim atëherë ne mund ta zëvendësojmë me propozimin e një kandidati tjetër, votojmë, e dërgojmë në Ministri dhe pastaj e shohim se a po pranohet apo jo, unë nuk kam zgjidhje tjetër, tërheqje nga propozimet nuk ka nga ana e Grupit të LVV-së, kështu që unë nuk dëshiroj të krijon kauzë këtu por vetëm mund të vazhdojmë me propozime dhe ju pyes se a mund të vazhdojmë me propozimin e një anëtari/e nga PDK në mënyrë që ta plotësojmë numrin prej 4 anëtarëve nga radhët e Kuvendit në përbërjen e Komitetit për Komunitete, meqë nuk po jepet propozim tjetër.

**z.Ekrem Rrahmani**, theksoi, do të ishte mirë të shkonim 5 minuta pauzë për konsultime.

**Kryesuesi i Kuvendit**, vazhdoi, unë e hedha në votim propozimin për pauzë ashtu siç e përcaktonte Rregullorja dhe nuk pati vullnet nga shumica sepse me vota të shumicës kalojnë propozimet, kështu që unë tani nuk kam hapësirë tjetër përveç vazhdimin të procedurave për themelimin e Komitetit në fjalë dhe ftoj Grupin e këshilltarëve të PDK-së të japin një propozim.

**znj.Mimoza Abdullahu**, theksoi, në emër të Grupit të PDK-së e propozojmë z.Lulzim Pollomin.

**Kryesuesi i Kuvendit**, vazhdoi, pra tani kemi 4 emra të propozuar nga radhët e Kuvendit, Flandra Kadriu, Demokrat Hodolli, Ardi Hasani, Lulzim Pollomi, pra janë 3 meshkuj dhe 1 femër, mirëpo ta shohim tutje edhe nga komunitetet jo shumicë se si po votohen sepse duhet pasë parasysh përfaqësimin gjinor.

Tani po shfrytëzoj rastin t'ju njoftoj me materialin e propozimeve që janë sjellë nga Komunitetet jo shumicë Rom, Agjiptas dhe Ashkali.

Muhamet Sadikun e kemi të propozuar, rruga "Ali Ajeti" në Podujevë, është nga Komuniteti Rom dhe ka edhe të dëshmuar nënshkrimet, do të thotë është vetëm një kandidat nga Komuniteti jo shumicë Rom, andaj meqë është vetëm një kandidat dhe mbi bazën që është obligim përfaqësimi i Komuniteteve jo shumicë, mund të votojmë që i përmenduri të jetë anëtar i Komitetit për Komunitete nga radhët e Komunitetit Rom.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 33 anëtar/e sa ishin prezent në sallë, 21 vota ishin PËR, asnjë KUNDËR, asnjë e PËRMBAJTUR (të tjerët nuk votuan), rrjedhimisht mbështetet që z.Muhamet Sadiku të jetë anëtar i Komitetit për Komunitete në emër të përfaqësimit të Komunitetit jo shumicë Rom.*

**Kryesuesi i Kuvendit**, vazhdoi, tani po ashtu kemi nga Komuniteti jo shumicë Egjiptas vetëm një kandidate të propozuar me 20 nënshkrime që është Sevdije Mustafa, andaj mund të votojmë edhe për këtë që të jetë anëtare e Komitetit për Komunitete nga radhët e Komunitetit Egjiptas.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 33 anëtar/e sa ishin prezent në sallë, 21 vota ishin PËR, asnjë KUNDËR, asnjë e PËRMBAJTUR (të tjerët nuk votuan), rrjedhimisht mbështetet që zj.Sevdije Mustafa të jetë anëtare e Komitetit për Komunitete në emër të përfaqësimit të Komunitetit jo shumicë Egjiptas.*

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, sa i përket Komunitetit Ashkali kemi 11 persona të propozuar kurse duhet të zgjedhën vetëm 3 prej tyre, atëherë po vazhdojmë veç e veç me paraqitjen e emrave të propozuar dhe po votojmë për secilin.

Kemi Rrahim Sejdiun, lagja e ashtuquajtur "Xhafer Meta" në rr."Skënderbeu" në Podujevë, i cili ka 42 nënshkrime nga pjesëtarët e Komunitetit Ashkali.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 32 anëtar/e sa ishin prezent në sallë, 19 vota ishin PËR, asnjë KUNDËR, asnjë e PËRMBAJTUR (të tjerët nuk votuan), rrjedhimisht mbështetet që z.Rrahim Sejdiu të jetë anëtar i Komitetit për Komunitete në emër të përfaqësimit të Komunitetit jo shumicë Ashkali në lagjen ku jetojnë ky Komunitet në rr."Skënderbeu" Podujevë.*

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, me radhë kemi Ramiza Ahmetin-Podujevë me 57 nënshkrime.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 33 anëtar/e sa ishin prezent në sallë, asnjë votë nuk ishte PËR, rrjedhimisht nuk mbështetet që zj.Ramize Ahmeti të jetë anëtare e Komitetit për Komunitete.*

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, tani votojmë për Vlorjana Avdiun.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 33 anëtar/e sa ishin prezent në sallë, 19 vota ishin PËR, asnjë KUNDËR, asnjë e PËRMBAJTUR (të tjerët nuk votuan), rrjedhimisht mbështetet që zj.Vlorjana Avdiu të jetë anëtare e Komitetit për Komunitete në emër të përfaqësimit të Komunitetit jo shumicë Ashkali në fshatin Orllan.*

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, kemi Doruntina Tahirin rr."Ali Ajeti"-Podujevë, 55 nënshkrime.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 33 anëtar/e sa ishin prezent në sallë, asnjë votë nuk ishte PËR, rrjedhimisht nuk mbështetet që zj.Doruntina Tahiri të jetë anëtare e Komitetit për Komunitete.*

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, në radhë kemi të propozuarin Xhevdet Kovaçi.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 33 anëtar/e sa ishin prezent në sallë, asnjë votë nuk ishte PËR, rrjedhimisht nuk mbështetet që z.Xhevdet Kovaçi të jetë anëtar i Komitetit për Komunitete.*

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, vazhdojmë me të propozuarën Fikmete Qurkollli.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 33 anëtar/e sa ishin prezent në sallë, asnjë votë nuk ishte PËR, rrjedhimisht nuk mbështetet që znj.Fikmete Qurkollli të jetë anëtare e Komitetit për Komunitete.*

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, vazhdojmë me të propozuarën Shkurte Sejdiun.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 33 anëtar/e sa ishin prezent në sallë, asnjë votë nuk ishte PËR, rrjedhimisht nuk mbështetet që znj.Shkurte Sejdiu të jetë anëtare e Komitetit për Komunitete.*

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, po ashtu vazhdojmë me të propozuarën e radhës Fatlume Rexhepi.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 33 anëtar/e sa ishin prezent në sallë, asnjë votë nuk ishte PËR, rrjedhimisht nuk mbështetet që znj.Fatlume Rexhepi të jetë anëtare e Komitetit për Komunitete.*

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, i propozuari i radhës është Murat Bajrami.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 33 anëtar/e sa ishin prezent në sallë, asnjë votë nuk ishte PËR, rrjedhimisht nuk mbështetet që z.Murat Bajrami të jetë anëtar i Komitetit për Komunitete.*

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, në radhë kemi të propozuarin Xhafer Ademi.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 33 anëtar/e sa ishin prezent në sallë, 20 vota ishin PËR, asnjë KUNDËR, asnjë e PËRMBAJTUR (të tjerët nuk votuan), rrjedhimisht mbështetet që z.Xhafer Ademi të jetë anëtar i Komitetit për Komunitete në emër të përfaqësimit të Komitetit të shumicë Ashkali në lagjen ku jetojnë ky Komunitet në rr. "Ali Ajeti" në Podujevë.*

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, dh është i propozuari Lavdim Bajrami.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 33 anëtar/e sa ishin prezent në sallë, 4 vota ishin PËR, asnjë KUNDËR, asnjë e PËRMBAJTUR (të tjerët nuk votuan), rrjedhimisht nuk merr votat e nevojshme në raport me të tjerët, që z.Lavdim Bajrami të jetë anëtar i Komitetit për Komunitete.*

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, pra votimet për anëtarët e propozuar nga radhët e Komuniteteve jo shumicë përfunduan, po i lexoj emrat e përbërjes së Komitetit për Komunitete sipas propozimeve përkatëse si dhe mbështetjes veç e veç nga votimet paraprake.

Nga Kuvendi i Komunës janë propozuar: Flandra Kadriu, Demokrat Hodolli, Ardi Hasani, Lulzim Pollomi. Pra kemi 3 meshkuj dhe 1 femër, po ashtu nga Komunitetet jo shumicë kemi 2 femra dhe 2 meshkuj e me këtë përbërje nuk ka përfaqësim gjinor sepse duhet të jetë 4 me 5 në këtë rast.

**znj.Adelina Stublla**, theksoi, i nderuar Kryesues, nëse veç e respektojmë mendoj se i'a dalim që për 5 minuta të kemi konsultime, andaj propozoj pauzë 5 minuta meqë kemi të bëjmë me çështjen e përfaqësimit gjinor dhe duhet të ketë përfaqësim gjinor, andaj për këtë edhe kërkuam pauzë, jo për diçka tjetër.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, meqë çdo propozim për pauzë duhet të hedhet në votim, andaj urdhëroni e hedh në votim që të shkohet në pauzë të shkurtër ashtu siç e propozoj parafolësja.

*Nga 33 anëtarë/e të Kuvendit sa ishin prezent, nga 20 prej tyre (me shumicë të votave), mbështetet propozimi i znj. Adelinë Stublla për një pauzë të shkurtër me qëllim të konsultimeve dhe gjetjes së një zgjidhje sa i përket propozimeve dhe zgjedhjes së anëtarëve/eve të Komitetit për Komunitete nga radhët e Kuvendit të Komunës.*

### **Pauzë, (ora 11:15)**

### **Pas Pauzës, mbledhja vazhdoi në orën 11:45.**

**Kryesuesi i Kuvendit**, konstatoi se prezent janë të gjithë anëtarët/et e Kuvendit që ishin prezent në fillim të mbledhjes, anëtarët/et e njëjtë të Ekzekutivit si dhe të pranishmit tjerë të lartcekur. Në vazhdim theksoi, pauza zgjati pak më shumë se sa ishte e paralajmëruar, tani nga ne Grupi i këshilltarëve të PDK-së ka një propozim të ri që do ta paraqet Mimoza Abdullahu.

**znj. Mimoza Abdullahu**, theksoi, ne Grupi i PDK-së e tërheqim propozimin e dhënë që ishte Lulzim Pollomi dhe e propozojmë kolegen Rinesa Goxhufi për anëtare në këtë Komitet.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, tani i kemi emrat e të gjithëve për anëtarë/e në përbërjen e Komitetit për Komunitete, pra sa për transparencë po i lexoj edhe njëherë të gjithë emrat:

Flandra Kadriu, Ardi Hasani, Demokrat Hodolli, Rinesa Goxhufi, Rrahim Sejdiu, Vlorjana Avdiu, Xhafer Ademi, Muhamet Sadiku, Sevdije Mustafa.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 33 anëtarë/e të Kuvendit sa ishin prezent në sallë, me 21 vota PËR, 1 votë KUNDËR, asnjë votë e PËRMBAJTUR (të tjerët nuk votuan), miratohet Propozim vendimi për themelimin dhe përbërjen e Komitetit për Komunitete, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes, dhe përbërjen si në vijim:*

- 1. Flandra Kadriu, anëtare nga subjekti politik LVV*
- 2. Ardi Hasani, anëtar nga subjekti politik LVV*
- 3. Demokrat Hodolli, anëtar nga subjekti politik Guxo*
- 4. Rinesa Goxhufi, anëtare nga subjekti politik PDK*
- 5. Rrahim Sejdiu, anëtar nga radhët e komunitetit jo shumicë - Ashkali*
- 6. Vlorjana Avdiu, anëtare nga radhët e komunitetit jo shumicë - Ashkali*
- 7. Xhafer Ademi, anëtar nga radhët e komunitetit jo shumicë - Ashkali*
- 8. Muhamet Sadiku, anëtar nga radhët e komunitetit jo shumicë - Rom*
- 9. Sevdije Mustafa, anëtare nga radhët e komunitetit jo shumicë - Egjiptas*

### **5. Propozim vendimi për ngritjen e komisionit për përzgjedhjen e drejtorëve/shave dhe zëvendës drejtorëve/shave në institucionet publike edukativo arsimore të Komunës së Podujevës**

**z. Avni Fetahu**, U.D. drejtor i Drejtorisë së Arsimit-DKA, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, theksoi, para jush keni propozim vendimin për ngritjen e komisionit për zgjedhjen e drejtorëve/shave dhe zëvendës drejtorëve/shave në institucionet publike edukativo arsimore të Komunës së Podujevës, ky propozim vie duke u bazuar në Ligjin dhe Rregulloren në fuqi. Anëtarë të komisionit kemi paraparë z. Blerim Vilasa zyrtar për arsim të mesëm të lartë nga DKA dhe znj. Bahrie Talla drejtoreshë nga SHFMU “Hyzriu e Samiu” në fshatin Letanc, ndërsa përfaqësuesin e Ministrisë varësisht prej nivelit të edukimit parafillor, fillor apo të mesëm e përcakton Ministria e Arsimit.

Kërkoj mirëkuptimin e juaj që dje nuk kam qenë në mbledhje të KPF-së, por jam njoftuar që janë kërkuar disa sqarime rreth numrit të pozitive e që prej këtyre pozitive që do të shpallen dy pozita janë të drejtorëve që do shkojnë në pension, dy drejtorëve ju skadon mandati. Kemi marrë një vendim ku është pavarësuar shkolla e fshatit Balloc, dhe 13 janë ushtrues detyre që në konkursin e fundit ose ju ka munguar ndonjë dokument ose nuk e kanë pasë kuotën e tre anëtarëve për konkurrencë që duhet ta kenë, pra gjithsej janë 18 pozita që duhet t'i nënshtrohen procesit të rekrutimit. Kërkoj nga ju mbështetjen për të vazhduar tutje.

**znj. Qëndresë Hajrizi**, theksoi, në emër të Grupit të LVV-së, e përkrahim propozim vendimin për ngritjen e komisionit për përzgjedhjen e drejtorëve/shave dhe zëvendësdrejtorëve/shave në institucionet publike edukativo arsimore të Komunës së Podujevës.

**z. Besim Latifi**, theksoi, në rrethana normale nuk do ta merrja fjalën për të diskutuar një çështje që në shikim të parë duket si procedurë dhe si vendim formal, mirëpo përbërja e këtij komisioni më obligon sot të flas jo vetëm si kuvendar por edhe si një njeri që vjen nga fusha e arsimit i cili e din nga afër se si ka rrjedhur ky proces herën e fundit, pikërisht me këtë përbërje të këtij komisioni.

Kjo çështje po rezulton se nuk është as procedurale, as teknike e as formale, ajo prekë drejtpërdrejtë sistemin arsimor në Komunën tonë, po flasim për një komision që do duhej të përzgjedh drejtorët e shkollave, drejtori i shkollës nuk është një menaxher i zakonshëm, ai është një autoritet profesional, pedagogjik, menaxherial dhe moral në shkollë. Drejtori përcakton klimën e punës në shkollë, cilësinë e mësimdhënies dhe raportin me nxënësit, prindërit dhe mësimdhënësit. Arsimi në thelb nuk është punë formale dhe nuk guxon të trajtohet si i tillë.

Sipas Rregullores 19/2024, komisioni përzgjedhës ka obligim të garantoj profesionalizëm, pa anshmëri dhe besueshmëri të plotë të procesit të përzgjedhjes, pikërisht këtu lind problemi kryesor me përbërjen e komisionit që u propozua, unë e kundërshtoj përbërjen e këtij komisioni, jo për arsye personale por për arsye parimore, profesionale dhe institucionale. Ky komision ka qenë edhe në konkursin e kaluar të vitit 2025 ku u përzgjedhën një numër i madh i drejtorëve të shkollave, të gjithë e dimë çka ndodhi më pas, ishte një skandal publik, pati drejtor shkollash që dolën publikisht me staturë në Facebook duke falënderuar Kryetarin e Komunës dhe drejtorin e DKA-së, për përzgjedhjen e tyre, e ky fakt ngreh një pyetje shumë serioze, a janë përzgjedhur drejtorët nga një komision profesional apo nga drejtori i DKA-së dhe Kryetari i Komunës, kjo tregon qartë deri ku ka arritur vasaliteti dhe politizimi në përzgjedhjen e drejtorëve të shkollave, kur drejtori i shkollës ndien nevojën të falënderoj politikën për pozitën që mban atëherë më ai nuk është një drejtues i pavarur por është produkt i një procesi të kapur.

Komisione formale për konkurse formale ku procedura respektohet në letër ndërsa rezultati dihet paraprakisht, komisioni shndërrohet në mekanizëm legjitimues e jo në një trupë real vlerësues, fatkeqësisht ky është realiteti që kemi përjetuar dhe e kemi parë të gjithë. Rregullorja për përzgjedhjen e drejtorëve kërkon që anëtarët e komisionit të kenë pavarësi profesionale dhe të garantojnë një proces të drejtë dhe të besueshëm, ndërsa me këtë përbërje ky standard nuk përmbushet, jo për shkak të një shkelje të drejtpërdrejtë ligjore por për shkak të mungesës së besimit publik, mungesës së kredibilitetit profesional dhe precedentit të keq që tashmë ekziston.

Prandaj si kuvendar por edhe si njerëz që kemi punuar në arsim një pjesë e jona e kemi obligim moral dhe institucional ta kundërshtojmë këtë propozim vendim. Arsimi nuk është fushë për eksperimente politike, drejtori i shkollës nuk është funksion që ndahet në pazar dhe me mirënjohje publike, për këtë arsye ne nuk e mbështesim këtë propozim vendim dhe kërkoj që përbërja e komisionit të rishikohet dhe në vend të një drejtori të shkollës të vendoset patjetër një ekspert i pavarur i arsimit ashtu siç e thotë Rregullorja në mënyrë që procesi të jetë realisht profesional i pavarur dhe i besueshëm për qytetarët e Podujevës.

**z.Ekrem Rrahmani**, theksoi, e ceku drejtori i DKA-së që dje s'ka qenë prezent në mbledhje të KPF-së, unë në atë mbledhje kam kërkuar listën e shkollave ku kanë me u emëruar këta drejtor dhe zëvendësdrejtor, herën e kaluar këtë listë na e ka dërguar së bashku me materialin e mbledhjes por këtë radhë mungon edhe lista, prandaj meqë u përmend, edhe njëherë ne kërkojmë që të propozohet një anëtar i komisionit e ai të jetë ekspert i arsimit, ndoshta s'ka mbetë Podujeva pa asnjë ekspert të arsimit dhe nëse s'ka ndonjë ekspert të arsimit për këtë komision për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve që thuhet se ky anëtar duhet të ketë performancë të lartë e unë se di çfarë performance ka ajo drejtoresha që e propozoi drejtori i DKA-së. Parimisht e kam thënë edhe herën e kaluar që komision që nuk i jep raport Kuvendit unë nuk votoj, nuk po them që në këtë pjesë i ka fajet drejtori i DKA-së ngase në rast se e thotë ligji që ky duhet t'i sjellë këtu këto propozime që ne t'i votojmë, unë nuk e votoj, një njeri që nuk vjen në Kuvend të më jap raport.

**znj.Gresa Qosa-Maqastena**, theksoi, desha të pyes drejtorin e DKA-së, ku jeni bazuar ju që po e propozoni po të njëjtën e cila ka qenë herën e kaluar në komision kur ju e dini që të gjitha shkollat ka po ashtu edhe drejtoresha tjera të cilat mund të jenë në përbërje të këtij komisioni e jo një drejtoreshë të mishërohet se ajo është mishëruar tash me këtë komision dhe ky komision duhet të jetë a politik. Në momentin që ju e keni pasë, së paku në këtë komision këtu humb kredibiliteti i arsimit i nderuar drejtor, nuk ka besueshmëri në popull në këtë vend ku ne jetojmë për drejtorët të cilët ti ke për t'i emëruar. Unë them që të propozohet dikush tjetër, të jetë i fushës së arsimit, të ketë performancë të lartë në arsim, ta njohë fushën e arsimit, ka edhe plot të tjerë. Nuk jam kundër propozimit të emrit, mirëpo ajo ka qenë në komision, ka edhe shumë tjera që e njohin shumë mirë fushën e arsimit dhe që janë menaxhere dhe kanë performancë të lartë dhe drejtori i DKA-së e din shumë mirë këtë punë, kështu që unë besoj që ju keni edhe shumë emra tjerë.

Unë e di që ju e propozoni edhe e miratoni dhe do të votohet, mirëpo për të mos humbur edhe pak që na ka mbet kredibilitet e besueshmëri në arsim sepse baza e krejt këtij vendi është në shëndetësi dhe në arsim, kur nuk ka besueshmëri në arsim, ku doni të vazhdoni tutje, kështu që ju lutem i nderuar drejtor sepse ka njerëz që janë apolitik të cilët e njohin shumë mirë fushën e arsimit dhe mund të jenë pjesë e këtij komisioni.

**z.Ermal Osmani**, theksoi, përbërja e këtij komisioni ka një tendencë të hapur për të ndikuar në përzgjedhjen e drejtorëve të shkollave ashtu siç ka ndodhur edhe në mandatin e kaluar, të gjithë e dimë që nga i pari e deri te i fundi drejtorët kanë falënderuar Kryetarin e Komunës dhe drejtorin e DKA-së, kjo flet qartë për dështimin e këtij komisioni për të qenë i pavarur. Nuk besoi që kriteri kryesor të jetë që të hyhet në Facebook të drejtorit e të shikohet se kujt po ia bën "like" apo koment në postime, zotëri Avni kjo nuk është as kriter profesional, as moral e as ligjor, për këtë arsye ky komision duhet të ndryshohet, unë e di që brenda DKA-së, ka ish drejtor të DKA-së, ka drejtor të shkollave me përvojë shumë vjeçare, ndërsa mendoj se duhet të jetë edhe një përfaqësues i pavarur i arsimit në këtë komision nëse vërtetë duam që ky proces të jetë sado pak i besueshëm.

**z.Avni Fetahu**, U.D. drejtor i DKA, theksoi, faleminderit për sugjerimet dhe këshillat, fillimisht do të dëshiroja që matjen e kredibilitetit të secilit anëtar të komisionit që është aty, para se të bëjmë propozimin ne për secilin prej tyre e dimë që ka përfunduar fakultet me 35 deri 40 provime që i vlerëson një mësimdhënës universitar, duhet pasë parasysh këtë para se me dhënë vlerësimin dhe para se me matë kredibilitetin e tyre. Ky komision që ka qenë edhe herën e kaluar dhe të njëjtit duke i respektuar në përpikëri parimin e ligjshmërisë, 13 prej tyre kanë mbet prapë ushtrues detyre, ata 13 ne kemi pas dëshirë që të jenë drejtor mirëpo nuk i kanë respektuar kriteret dhe 13 prej tyre kanë mbet ushtrues detyre, kjo konstaton që ata e kanë zbatuar ligjin dhe rregulloret. Pra sa i përket dy anëtarëve të komisionit, tashmë janë të dëshmuar dhe përveç matjes së vlerësimit të

performancës që i bëhet nga DKA-ja, ju ka bërë vlerësimi i performancës edhe nga Ministria e Arsimit, kështu që kanë një opinion të mirë.

Prej gjithë këtyre drejtorëve që po i potenconi ju që janë politik, ju merreni e shikoni listën dhe rreth 60% së paku prej tyre, janë po ata që ju i keni besuar më herët, të njëjtit janë dhe nuk është që ka ndryshuar diçka, nëse kanë qenë shumë jo profesional atëherë nuk e di përse i keni mbajtur në atë kohë, kështu që me po të njëjtit po punojmë por jam i bindur se kam kaluar edhe unë për atë proces me më pak ngarkesa se që i kemi dhënë ne këtu, pra po e përfshijë edhe vetën.

Krejt në fund, falënderimin mendoj që ata janë të lirë ta bëjnë edhe pse s'ia ka obliguar askush por jam i bindur që ata nuk kanë arsye t'ju falënderojnë juve, nëse pritni t'ju falënderojnë juve si subjekt politik (LDK) jeni gabim, nëse na falënderojnë neve është në vullnetin e tyre dhe nuk është që i kemi matur. Më vie keq që më duhet ta përsërisë sërish që edhe herën e kaluar kur e kemi pasë vendimin e komisionit në fjalë në legjislaturën e kaluar, e pata potencuar që për fat të keq edhe Bill Gates, me ua sjellë juve ju prapë se votoni, kështu që nuk kemi çfarë të bëjmë.

**z.Ekrem Rrahmani**, theksoi, në bazë të fjalimit dhe logjikës që e tha drejtori parafolës, në materialin që e ka dërguar ai është edhe vet U.D, a i bie kjo që s'ka performancë dhe si ka besuar Kryetari që e ka bërë U.D, dhe pse është U.D e nuk është drejtor, e them këtë sepse në material ku është nënshkrimi dhe vula, shkruan ushtrues detyre i drejtorit të Drejtorisë së Arsimit, andaj do të doja të na sqaroj pse ka mbet U.D, a është i dobët e si ka besuar a pse.

**znj.Gresa Qosa-Maqastena**, theksoi, drejtori Fetahu e përmendi performancën e Ministrisë së Arsimit, andaj e pyes drejtorin, a kjo e ka performancën më të lartë apo ka edhe dikush tjetër që ka performancë të mirë për udhëheqje. Unë nuk e potencova që është politike, vetëm e theksova që mund të mishërohet në këtë komision dhe pa tjetër kërkova të ndryshohet sepse ka shumë drejtor tjerë që mund të jenë pjesë e këtij komisioni.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, meqë nuk ka të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën rreth kësaj pike të rendit të ditës unë e hedh në votim propozim vendimin për ngritjen e komisionit për përzgjedhjen e drejtorëve/shave dhe zëvendësdrejtorëve/shave në institucionet publike edukativo arsimore të Komunës së Podujevës, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 33 anëtarë/e të Kuvendit sa ishin prezent në sallë, me 21 vota PËR, 12 vota KUNDËR, asnjë votë e PËRMBAJTUR, miratohet Propozim vendimi për ngritjen e komisionit për përzgjedhjen e drejtorëve/shave dhe zëvendësdrejtorëve/shave në institucionet publike edukativo arsimore të Komunës së Podujevës, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.*

## **6. Propozim vendimi për miratimin e Listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2026**

**znj.Saranda Stublla-Uka**, U.D. drejtoresh e Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë-DPKGJ, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, theksoi, pra si pikë e rendit të ditës kemi propozim vendimin për miratimin e Listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2026, me ligj është parashikuar që publikimi i Listës së veçantë të pronave të bëhet deri më datë 31 dhjetor, mirëpo për shkak të zgjedhjeve lokale që janë mbajtur në muajin tetor të vitit të kaluar dhe për shkak të konsolidimit të Kuvendit, me Shkresën e MAPL-së që iu është dërguar Kryetarëve të Komunave është shtyrë afati i publikimit deri më 31 mars të vitit 2026.

Po ashtu i propozoj Kuvendit që në faqen 8 dhe 9 të Listës, te parcela me nr.154-1 dhe 154-2 është bërë një gabim teknik ku planifikohet të jepen në shfrytëzim në afatin kohor afatshkurtër, por duhet të bëhet afati kohor afatgjatë, andaj kërkoj nga ana juaj që ta përkrahni këtë propozim vendim si pikë të rendit të ditës, me këto plotësim ndryshime.

**z.Abedin Zeka**, theksoi, në emër të Grupit të LVV-së ne e përkrahim këtë propozim vendimi për miratimin e Listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2026.

**z.Ekrem Rrahmani**, theksoi, në nenin që është thirr, për këtë pikë është neni 13 ku thuhet shumë kuartë, komuna duhet të publikoj listën e përgjithshme të pronave të paluajtshme të komunës si dhe listën e veçantë të pronave që planifikohen për dhënie në shfrytëzim për vitin vijues deri më 31 dhjetor duke arsyetuar interesin publik dhe zhvillimin ekonomik të komunës. Atë që e tha drejtoresha parafolëse deri më 31 mars, unë nuk e kam gjetur askund, nuk e di pse këtë vit duhet të shkojmë deri më 31 mars edhe pse e tha në mënyrë goxha interesante se lista duhet të publikohet, ne kemi ardh këtu të votojmë për publikim të listës e kjo është në kundërshtim me ligjin.

Në vitin e kaluar, në muajin maj e kanë sjellë thuajse të njëjtën edhe këtu e kam vendimin e MAPL-së që e ka anuluar, po e lexoj arsyetimin e MAPL-së, (arsyeja e anulimit të këtij vendimi sipas nenit 1 është për shkak se Ministria e Administratës së Pushtetit Lokal ka vlerësuar se akti i komunës nuk është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi. Komuna duhet ta publikoj listën e përgjithshme të pronave të paluajtshme të komunës si dhe listën e veçantë të pronave të planifikuara për dhënie në shfrytëzim për vitin vijues deri më 31 dhjetor). Këtu ne nuk e kemi listën e përgjithshme të pronave, është veç një listë e veçantë dhe ka shumë prona që unë e di që mungojnë në këtë listë, ka kaluar afati ligjor por nëse këta i kanë borxh dikujt dhe i kanë thënë ne e qesim por opozita e kundërshton do të thotë e kanë sjellë me vetëdije dhe e dinë që ky vendim kthehet mbrapsht dhe është i pa ligjshëm, e pastaj pas një muaji në këtë foltore ua sjell anulimin.

**z.Lulzim Pollomi**, theksoi, në emër të Grupit të këshilltarëve të PDK-së e përkrahim miratimin e Listës së veçantë për pronat e paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2026, sepse ne besojmë që kjo çështje lidhet drejtpërdrejtë me interesin publik dhe zhvillimin ekonomik të Komunës së Podujevës. Megjithatë përkrahja jonë shkon paralelisht me kërkesën për transparencë dhe llogaridhënie, kërkojmë që gjatë vitit të raportohet në Kuvendin e Komunës për përfitimet konkrete që burojnë nga dhënia në shfrytëzim të këtyre pronave dhe për ndikimin real të tyre në ekonominë lokale sepse besojmë shumë që qytetarët kanë të drejtë ta dinë se si shfrytëzohet prona publike dhe çfarë përfitimi real u kthehet atyre nga këto vendime.

Vetëm me transparencë dhe përgjegjësi mund të sigurojmë zhvillimin e drejtë dhe të qëndrueshëm për Komunën tonë.

**z.Besim Latifi**, theksoi, mos miratimi me kohë i Listës së pronave për dhënie në shfrytëzim për vitin 2026 ka futur Komunën në një boshllëk ligjor serioz dhe të rrezikshëm. Sipas ligjit për dhënie në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme komunale në nenin 13 paragrafi 1 thuhet Lista e pronave që planifikohet për dhënie në shfrytëzim duhet të miratohet deri më 31 dhjetor, pra është dispozitë e qartë, të vitit përkatës fiskal. Ky afat nuk është funksional dhe nuk lë asnjë hapësirë për interpretime, kur dihet se afati është i përcaktuar qartë me ligj, sot ndodhemi në një situatë ku po tentohet të martohet një listë jashtë afatit ligjor duke krijuar përshtypje se dikush këtu mendon se është mbi ligjin dhe ligji mund të anashkalohet sipas interesit politik të ditës. Pasojat janë konkrete dhe të prekshme, pa listë të miratuar për vitin 2026 nuk mund të vazhdojnë kontratat ekzistuese, nuk mund të lidhen kontrata të reja dhe nuk mund të inkasohen të hyra nga prona publike, kjo përbën dëm të drejtpërdrejtë për buxhetin komunal ndërsa shfrytëzuesit potencial të këtyre pronave kanë mbetur pa kontrata jo për fajin e tyre po për shkak të mos veprimtimit dhe pa

përgjegjesisë së pushtetit lokal. Sipas nenit 23 paragrafi 2 të këtij ligji, Kryetari i Komunës obligohet që ta njoftoj Kuvendin e Komunës pas përfundimit të çdo kontrate të dhënies në shfrytëzim duke raportuar për gjendjen e pronës dhe duke dhënë propozime për destinimin e saj në të ardhmen. Një raport të tillë ky Kuvend nuk e ka pasë para vetës, pra para se kjo listë të vije për miratim ashtu siç kërkohet me ligj është dashur me pasë këtë raport sepse është obligim ligjor.

Ne e dimë shumë mirë se zvarritja e këtij procesi nuk ka qenë rastësi, ka qenë e qëllimshme, arsyeja është politike, keni zgjedhur ta mbani të fshehtë koalicionin me PDK-në, dhe keni pritur të kalojnë zgjedhjet nacionale për t'i mashtruar qytetarët, për të marrë ndonjë votë më shumë sepse po të kishit sinqeritet ndaj qytetarëve kjo listë do të ishte miratuar në dhjetor brenda afatit ligjor.

Nuk ka munguar koha e as zgjidhja, ka munguar vullneti politik, sot po tentohet të legalizohet një shkelje ligjore pas afatit, ne nuk e pranojmë këtë qasje. Prona publike është pasuri e qytetarëve dhe duhet të administrohet me ligj, transparencë dhe përgjegjësi e jo me bllokada politike dhe pazare të fshehta për kalkulime afatshkurta. Sot ne nuk votojmë vetëm për prona por po votojmë nëse ligji vlen për të gjithë apo vetëm për qytetarët, nëse kjo listë kalon jashtë afatit ligjor atëherë mesazhi është i qartë se pushteti vendos mbi ligjin, ne këtë nuk mund ta pranojmë andaj edhe nuk do të bëhemi pjesë e kësaj shkelje të hapur ligjore.

**znj.Saranda Stublla-Uka**, U.D. drejtoresh e DPKGJ, theksoi, së pari po i përgjigjem z.Ekrem Rrahmanit, e që edhe dje në KPF i sqarova, në muajin maj të vitit 2025 nuk ka qenë miratimi i Listës së veçantë por ka qenë ndryshimi i afatit kohor të një parcele që është përfshirë në Listën e veçantë të vitit 2025 e cila është miratuar në dhjetor të vitit 2024. Ndërsa sa i përket afatit kohor për miratimin e Listës së veçantë, këtu e kam Shkresën e Ministrisë që i është dërguar të gjithë Kryetarëve të Komunave që për shkak të zgjedhjeve lokale që janë mbajtur në fund të vitit të kaluar është shtyrë afati i publikimit deri më 31 mars të këtij vitit. Kjo ka ndodh edhe më herët dhe nuk është hera e parë sepse edhe në zgjedhjet e kaluara është shtyrë afati i miratimit të kësaj Liste.

**z.Ekrem Rrahmani**, theksoi, e di që në muajin dhjetor të vitit 2024 e kemi votuar në Listën për vitin 2025, por në maj është tentuar të ndryshohet afatin e dhënies në shfrytëzim nga 10 vite në 99 vite për një parcelë, por Ministria e ka përcaktuar saktë sepse ka thënë asnjë veprim nuk mund ta marrësh brenda vitit, vetëm deri më datë 31 dhjetor, andaj realisht aty është përgjigjja, atë as nuk guxon ta ndryshoj e as me vënë në votim. Unë ju thash, nëse ti e ke Shkresë prej Ministrisë që ka pasë zgjedhje dhe duhet deri më datë 31 mars të shtyhet afati, unë vetëm e kërkova ligjin në bazë të cilit është bazuar Ministria, në çka është thirr Ministria, apo e ka pasë dikush dajë atë që ta ka dërguar atë letër, ose a është thirr në ndonjë nen të ndonjë ligji që kur ka zgjedhje duhet të shtyhet afati deri më 31 mars, e them këtë sepse unë në ligjin për prona këtë nuk e kam gjet askund, unë kërkova nga ju ta cekeni ligjin ku është përcaktuar që nëse ka zgjedhje zgjatet afati kohor për dhënie në shfrytëzim të pronave të Komunës.

**z.Besim Latifi**, theksoi, është mirë që kur te dërgoni materialin e nderuar drejtoreshë e sidomos kur keni ndonjë përgjigje ose Shkresë prej organeve që janë në nivel më të lartë se ju, atë Shkresë të na e përcillni me material, ne krejt çka kemi pasë para vetës kanë qenë pronat të cilat i keni publikuar për dhënie në shfrytëzim dhe nuk e kemi pasë një Shkresë të tillë të Ministrisë.

Është e nevojshme dhe arsyeshme të na e dërgoni Shkresën dhe ta shohim ne se në çfarë baze ligjore është mbështetur për arsye se unë besoj edhe sot që ka njerëz që janë duke i shfrytëzuar këto prona publike pa kontrata, janë duke i shfrytëzuar pronat publike jashtë juridiksionit pa kontrata, pa asgjë hiç, prandaj duhet me qenë korrekt me Kuvendin, të na dërgoni materialet siç duhet dhe arsyetimet ashtu siç i kërkojmë.

**z.Ekrem Rrahmani**, theksoi, pyes, a është Lista e përgjithshme e publikuar sepse për Listën e veçantë po e kuptoj që është, ngase në vendimin e kthyer nga Ministria, në arsyetim thuhet që duhet me qenë Lista e përgjithshme dhe Lista e veçantë deri më 31 dhjetor.

**znj.Saranda Stublla-Uka**, U.D. drejtoresh e DPKGJ, përgjigje parafolësit, theksoi, Lista e përgjithshme është e publikuar në ueb faqe të Komunës, ndërsa Lista e veçantë ka ardhë sot këtu për miratim, kurse tani deri më 31 mars të këtij viti do ta bëjmë sërish publikimin e Listës së re të përgjithshme për vitin 2026.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, edhe unë pajtohem me këshilltarin parafolës që e ceku se materialet duhet të jenë të kompletuara dhe çdo material që vjen në lidhje me temën duhet t'i dërgohet edhe këshilltarëve në mënyrë që të përgatiten dhe që diskutimet të mos zgjaten pastaj.

Tani meqë diskutimet pothuajse përfunduan, pa humbur kohë më shumë e vë në votim propozim vendimin për miratimin e Listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2026, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes, përfshirë edhe plotësim ndryshimin e propozuar në fjalën hyrëse nga U.D Drejtoreshë e DPKGJ.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 33 anëtarë/e të Kuvendit sa ishin prezent në sallë, me 21 vota PËR, asnjë votë KUNDËR, asnjë votë e PËRMBAJTUR (të tjerët nuk votuan), miratohet Propozim vendimi për miratimin e Listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2026, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes, përfshirë edhe plotësim ndryshimin e propozuar në fjalën hyrëse nga U.D Drejtoreshë e DPKGJ, dhe atë që:*

*-Në rubrikat 11 në faqen 8 të Listës, e dhëna për periudhën kohore për dhënien në shfrytëzim, për Njësinë kadastrale P-1541-2, ku thuhet ....planifikohet të jepet në shfrytëzim afatshkurtër, ndryshohet si në vijim, .....planifikohet të jepet në shfrytëzim afatgjatë.*

*-Në rubrikën 12 në faqen 9 të Listës, e dhëna për periudhën kohore për dhënien në shfrytëzim, për Njësinë kadastrale P-1541-1, ku thuhet ....planifikohet të jepet në shfrytëzim afatshkurtër, ndryshohet si në vijim, .....planifikohet të jepet në shfrytëzim afatgjatë.*

## 7. Të ndryshme

**znj.Luljeta Muqolli-Azemi**, theksoi, më lejoni të inicioj kërkesën për formimin e Grupit jo formal të grave asamblistë, andaj ju ftoj të gjitha gratë asamblistë që të hënën në ora 10:00, në sallën nr. 52, të takohemi të gjithë së bashku.

**z.Ekrem Rrahmani**, theksoi, a ka mundësi me ditë pse po bëhet gjithë ky reduktim i ujit në Komunën e Podujevës, a vetëm unë po e shohë apo vetëm po më duket që ne po trajtohem si qytetar të rendit të dytë, nëse 1000 m<sup>3</sup> ujë prodhohen në Batllavë dhe shkojnë për Prishtinë, pse nuk ndahet të paktën një pjesë prej 30% e atij uji për Podujevë, tek ne është Liqeni kurse ata atje duhet me pasë ujë gjithqysh 24 orë e që nuk jam asgjë kundër e ne mos të kemi ujë hiç. Në këtë rast nuk po flas për veten sepse në përgjithësi në qytet nuk ka pasë ujë, dhe jo pak sepse ka lagje në qytet që nga 1 janari e këndeje nuk ka ujë, prandaj kërkoj një përgjigje sepse keni pas një vizitë atje pas gjitha atyre kritikave, andaj na tregoni sepse e di që keni qenë në një vizitë dje, përse nuk ndahet një pjesë e ujit për Komunën e Podujevës, sidomos për qytet ose për lagje ku nuk kanë bunare apo puse të ujit.

**znj.Gresa Qosa-Maqastena**, theksoi, kam një pyetje për drejtoreshën e DSHMS-së, përse nuk punon rëntgeni në Urgjencën e Spitalit dhe a ju duket juve që ata pacientë që shkojnë me urgjencë në qytet të kthehen në Emergjencë sërish me i marrë shërbimet në qytet, dhe sërish të kthen atje.

**znj.Rinesa Goxhufi**, theksoi, të nderuar koleg dhe të nderuar qytetarë, dua të ngrisë një shqetësim serioz për sigurinë publike në Komunën e Podujevës, i nderuari Nënkyetar i Komunës së Podujevës z.Fahri Restelica me shqetësim të thellë po ju drejtohem lidhur me rastet e shpeshta të përdorimit të armëve të zjarrit që po ndodhin në Komunën e Podujevës, dukuri kjo që së fundmi ka marrë përmasa alarmuese dhe ka rezultuar edhe me humbje jete, ngjarje të tilla përfshirë edhe me rastin e fundit të raportuar dje ku një person ka shtënë me armë automatike në mes të qytetit në ambiente publike dhe në afërsi të shkollave po krijon ndjenja të thella pasigurie te qytetarët dhe përbën rrezik serioz për jetën e qytetarëve dhe rendin publik. Këto veprime janë të pa pranueshme dhe përbëjnë rrezik potencial me pasoja katastrofale e veçanërisht për fëmijët dhe të rinjtë tanë.

Si Komunë nuk guxojmë të lejojmë që përdorimi i armëve të shndërrohet në dukuri të zakonshme andaj ne kërkojmë rritje të menjëhershme të masave të sigurisë dhe pranisë policore në zonat urbane dhe pranë institucioneve arsimore, veprime konkrete hetimore dhe parandaluese ndaj posedimit dhe përdorimit ilegal të armëve. Angazhimi institucional në fushatat e vetëdijesimit dhe pasojat ligjore e morale, njerëzore të përdorimit të armëve, koordinim të ngushtë ndërmjet institucioneve të sigurisë, pushtetit lokal dhe atij qendror, prandaj në këtë kontekst ju lus që ky shqetësim serioz të ngrihet në nivelet më të larta shtetërore përfshirë edhe Institucionet e sigurisë dhe ato edukative me qëllim të marrjes së masave konkrete parandaluese, rritjes së sigurisë publike dhe fuqizimit të fushatave vetëdijesuese për pasojat ligjore dhe njerëzore të përdorimit të armëve.

Veprimi i menjëhershëm institucional është i domosdoshëm për të parandaluar tragjedi të reja dhe për të rikthyer ndjenjën e sigurisë në Komunën e Podujevës.

**z.Artrit Mulliqi**, theksoi, unë e kam një pyetje për Drejtorinë e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, si dhe Drejtorinë e Inspeksionit, që ka të bëjë me kompanitë e ndërtimeve të larta, jemi dëshmitarë dhe të gjithë jemi gëzuar kur ka kaluar Harta Zonale dhe ka filluar zhvillimi urban i qytetit të Podujevës, mirëpo një gjë që nuk është duke më pëlqyer dhe jam duke e parë çdo ditë është njëfarë mënyre shkatërrimi i infrastrukturës nga këto kompani, ndoshta ndonjëherë e kanë të domosdoshme por ndonjëherë munden edhe të kursehen. Dy gjëra janë duke më penguar më shumë, mos pastrimi i gomave të kamionëve në vend punishte e që është një gjë shumë e thjeshtë që me pak investim mund të bëhet dhe mendoj që duhet të jetë rregull e shkruar për ta, do të thotë çdo herë kur dalin nga vend punishtet e baltosin komplet infrastrukturën urbane në tërë qytetin.

Gjëra tjetër është te Lagjja e Spitalit ku kompanitë të cilat kanë ndërtuar banesa, gjithë materialin që e kanë lënë në fund e kanë hedh në kanalizim pastaj ai material ka shkaktuar mbylljen e rrjetit të kanalizimit ku gjithë asaj lagjeje po na shkakton probleme, prandaj do të dëshiroja që në të ardhmen të kemi mbikëqyrje pak më shumë ndaj këtyre kompanive dhe rregulla pak më të qarta.

**z.Ardi Hasani**, theksoi, kam një pyetje për drejtorin e Drejtorinë e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, ka të bëjë me menaxhimin e qenve endacak, qysh është gjendja dhe deri ku kemi arritur rreth këtij shqetësimi për shkak se kemi shqetësime dhe adresime të qytetarëve anë e mbanë Komunës tonë. Për pasoj në lagjen nga vijë unë i kemi pasë dy sulme prej qenve endacak.

**z.Avni Islami**, theksoi, nëse më lejohet një përgjigje për sigurinë në Komunë që ishte pyetje për Nënkyetarin e Komunës z.Fahri Restelica, pra nëse është e mundur ta marrë fjalën kur është e arsyeshme rreth gjendjes së sigurisë në Komunën e Podujevës, rreth keqpërdorimit të armëve të zjarrit, për këtë kisha dashur që në kohë të përshtatshme të jap një përgjigje lidhur me këtë.

**z.Isak Ejupi**, theksoi, mora fjalën me shkas pas deklarimit të koleges parafolëse lidhur me nivelin e sigurisë në Komunën e Podujevës, fushë e cila sigurisht që më përket dhe një situatë që dje ka ndodh është tepër shqetësuese, absolutisht e rrezikon sigurinë e çdo qytetari por mbi të gjitha është fat i mirë që nuk ka pasë pasoja në njerëz, por trauma sigurisht që do të ketë edhe ka, prandaj duke qenë një kohë të gjatë në funksione të ndryshme por para së gjithash në Komunën e Podujevës si komandant i Stacionit Policor, arsyeja pse ndodh kjo është ndërhyrja e politikës në institucionet e pavarura edhe të sigurisë por edhe të drejtësisë e që në mënyrë absolute ka polarizim aq të skajshëm në këto institucione, ka ndërhyrje që me të vërtetë është e pa falshme sepse e cenon rëndë sigurinë dhe aplikimin e masave të sigurisë në mënyrë të paanshme. Unë këtu para vetes e kam një shkresë të cilën Kryetari i Komunës e ka bërë për të më larguar mua nga Podujeva ndërkohë që të njëjtën ditë unë jam përgjigjur dhe e kam demantuar çdo gërmë që ai e ka qitë sepse është shpifja absolute, por si do qoftë un po ju siguroj që Komuna e Podujevës, nivelin më të mirë të sigurisë e ka pasë në mandatin tim sepse kam qenë 24 orë në ditë i mishëruar me Stacionin Policor dhe me sigurinë e qytetarëve të Komunës së Podujevës.

Një gjë tjetër që po ashtu dua ta ndajë me ju është se në vitin 2006, me mandat ligjor, pra me Urdhëresë të Gjykatës e kam arrestuar Albin Kurtin, është mandat ligjor dhe shikoni çka shkruan, çfarë gënjeshtre shkruan Albin Kurti për mua që absolutisht nuk ka të bëjë fare me mua, këto thënie janë shpifje, janë gënjeshtër, por le t'i shërbej atij në ndërgjegjen e tij.

Unë kurrë në jetën time profesionalisht nuk kam bërë dallime në shërbim për sigurinë e vendit, por nuk është njëjti sikur të arrestosh sepse me mandat ligjor unë arrestoj secilin qytetar të Republikës së Kosovës, marrë parasysh a është Ministër/e, Kryeministër apo President i vendit, kjo është procedurë tjetër por realisht kjo është arsyeja përse sot e kemi sigurinë të cenuar dhe sot na bredhin qytetarët me armë automatike të shkatërrimit në masë në mes të qytetit e fati është i mirë prapë po them është që nuk ka pësuar askush përveç dëmeve materiale që kanë ndodh.

Për të pasë një siguri më të mirë duhet që njerëzit profesional me i lënë ta kryejnë punën e tyre e jo të ndërhyjë e të vendos politika se si duhet të sjellët një komandant i Stacionit apo një Zyrtar policor, ju sigurisht e keni parë atë komunikimin e Kryetarit z.Shpejtim Bulliqi, në shesh veç pse policia e ka dënuar një mjet që ka hyrë në shesh pa lejen e Komunës, unë jam i interesuar që ajo infrastrukturë të ruhet por nuk mund të ruhet ajo infrastrukturë nëse mjetet motorike hyjnë në atë shesh, andaj edhe policia ka marrë masat në përputhje të plotë me ligjin por që ndërkohë Kryetari i Komunës del atje dhe vetëm sa nuk i rrahë, sepse ai është mësuar me i rrahë edhe njerëzit, por po e them sinqerisht se këto ndërhyrje në institucionet e sigurisë e kanë sjellë këtë situatë ku sot që njerëzit dalin me armë të gjata nëpër shesh, prandaj kërkoj që ne t'i largojmë duart nga institucionet profesionale të sigurisë në mënyrë që të kemi siguri më të mirë sesa kemi tani.

**z.Fatri Zhitija**, theksoi, unë kam veç një pyetje për ish komandantin këtu, a ka pas ndërhyrje të politikës edhe gjatë kohës kur ky ka qenë komandant i Stacionit Policor, veç të na tregojnë këtë.

**z.Isak Ejupi**, përgjigje parafolësit, theksoi, unë e ceka, jo që nuk ka pasë por nuk kam pranuar kurrë në jetën time ndërhyrje, mbase edhe largimi im nga Stacioni policor në Podujevë është pikërisht për shkak që nuk kam pranuar një ndërhyrje të politikës, konkretisht të z.Xhelal Sveçla i cili gjatë kohës së fushatës së jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës, ka kërkuar një takim me mua por unë i kam kërkuar mirëkuptim përmes z.Arbër Sfishta i cili më duket ka qenë tek unë dhe që ka kërkuar takim, dhe unë i kam thënë që nuk ka mundësi sepse e kemi të ndaluar të komunikojmë me subjekte ose përfaqësues të subjekteve që janë në garë të një procesi politik, kjo është rregull tek ne dhe unë e kam evituar atë takim, mirëpo pse nuk e kam pranuar atë takim, pas dy dite më ka thirrë në telefon madje edhe më ka kërcënuar por se kam pas dert atë problem, më ka thënë, ti nuk ke dashtë me u marrë me mua por unë kam me u marrë me ty, dhe në momentin që ka

ardhë në pozitë është marrë me mua, do të thotë kjo është ndërhyrje flagrante e politikës në çështjet e sigurisë.

**z.Isak Shabani, Kryesues i Kuvendit**, theksoi, ju lus t'i drejtoheni Ekzekutivit për çështje të caktuara kush do që ka, por të mos bëjmë debate tani këtu, pra nëse ka shqetësime të ngritën për çështjet të cilat i kemi diskutuar.

**z.Artrit Mulliqi**, theksoi, një pyetje për kolegun ish komandant i Stacionit të Policisë, kur foli që në kohë e tij ka qenë siguria në nivel, a e ka fjalën vetëm për nxënës ose të rritur që dalin me kallash, apo e ka fjalën edhe për dukuritë tjera negative siç është haraçi, fajdeja, shantazhi dhe gjërat e tjera.

**znj.Arnisa Sylejmani**, theksoi, unë s'po flas as për arrestime e as për siguri, por vetëm dua të bëjë një pyetje edhe pse drejtori i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit nuk e di a është apo jo këtë apo cili është, mirëpo po i drejtohem me një kërkesë drejtorit të DSHPMSH z.Bahri Selimi, ka të bëjë me sanimin e gropave dhe e cila është kërkesë urgjente në shumë rrugë të qytetit të Podujevës të cilat paraqesin rrezik për sigurinë e qytetarëve dhe paraqesin dëmtimin e automjeteve, prandaj të merreni sa ma shpejtë me këtë çështje e t'i sanoni ato gropa sa më shpejtë.

**z.Ardi Hasani**, theksoi, sa i përket kërcënimit të z.Xhelal Sveçla që u tha, kjo nuk është aspak e vërtetë, unë kam qenë aty si bartës i aktiviteteve dhe kjo ka ndodh, adresimi i zotëri Sveçlës ka qenë kështu për dy arsye, e para për shkak të një kërcënimi, incidenti që e kem pasë prej LDK-së, disa zyrtarëve të LDK-së jo të gjithëve, e në anën tjetër i përfshirë në këtë incident ka qenë edhe një polic, polic i ish komandantit atëherë, për këtë arsye i'u ka adresuar z.Xhelal Sveçla, dhe për këtë ky ka refuzuar me ndërmarrë ose të ofroj siguri për secilin qytetarë përfshirë edhe neve si aktivistë që kemi qenë të kërcënuar para zyrave tona pa i bërë asgjë askujt, kjo është e vërteta.

**z.Isak Ejupi**, theksoi, sa i përket pyetjes së kolegut paraprak, si do qoftë unë po ia jep vetëm dy statistika për ta kuptuar cili ka qenë roli im për sigurinë e përgjithshme në Podujevë.

Në katër mujorin e parë të vitit 2012, kur unë nuk kam qenë komandant i Stacionit Policor këtu kanë qenë saktësisht 711 raste të raportuara në polici. Në vitin 2015 në të njëjtën periudhë i kam lënë saktësisht 300 raste, do të thotë janë 411 raste më pak për tri vite dhe kjo tregon sa kam punuar unë për ta përmirësuar sigurinë në Komunën e Podujevës.

Një statistikë tjetër, është hera e parë në historinë e Podujevës të pas luftës që një vit kalendarik përfundon pa asnjë vrasje, ndërkohë që keni qasje në statistika në Stacion të Podujevës dhe verifikojeni për 20 muaj sa isha unë në Podujevë nuk ka pasë asnjë vrasje, unë kudo që kam dëgjuar që ka ndonjë incident ose ka një shkëndi që mund të ketë një incident që prodhon një vrasje unë kam ndërhyrë dhe kam shkuar e kam qetësuar situatën dhe kam treguar rrugën qysh zgjidhet ai problem në mënyrë që të evitohet problemin serioz.

Sinqerisht ju them që sa i përket kërcënimit të z.Xhelal Sveçla unë telefonatën e kam marrë prej tij, por unë nuk e di kah e more ti këtë informacion kush ta dha ty këtë që ai s'më ka kërcënuar mua (i drejtohet parafolësit Ardi Hasanit).

Ai mua më ka thënë decidivisht, "ti s'ke dashtë me u marrë me mua por unë kam me u marrë me ty", ky është kërcënim, nëse ky nuk është kërcënim ti vlerësoje qysh të duash, të debatohet më shumë për këtë punë se kam ndër mend, por unë jam i gatshëm gjithmonë të jap kontribut në çështjet e sigurisë sepse është profil i imi dhe ju siguroj që askush nuk mund të ma heq një të drejtë që unë të kujdesem për familjen time, për lagjen time, për fshatin, për Komunën e Podujevës.

**z.Avni Islami**, theksoi, meqenëse jam nga fusha e sigurisë dua të ndalem pak te pyetja që e shtroi njëra prej kolegeve parafolëse por këtu me siguri jemi para mediave dhe dikush na përcjell dhe qëllimi i mbledhjes dhe vendimeve që merren këtu dhe rekomandimit është që ne të jemi në shërbim të qytetarit. Pyetja ishte jashtëzakonisht e qëlluar sepse ishte një shqetësim rreth gjendjes së sigurisë në Komunën e Podujevës, vetëm dua të theksoi që në të gjitha statistikën në Republikën e Kosovës, Komuna e Podujevës është një ndër komunat më të qeta ku ka më pak incidente, plagosje, vrasje etj. Absolutisht asnjë rast nuk amnistohet, pra edhe rasti që ka ndodhur dje ku një i ri me kallashnikov lëviz në gjendje të pa kontrolluar, mirëpo nuk duhet harruar se raste të tilla kemi edhe në shtetet më të zhvilluara si në SHBA, Angli e vende të tjera, pra nuk dua ta amnistoj mirëpo në përgjithësi gjendja e sigurisë në Komunën e Podujevës është e kënaqshme.

Ne absolutisht nuk do duhej të kënaqeshim në asnjë rrethanë, por duhet që vazhdimisht të punojmë mirëpo nuk duhet ta shfrytëzojmë foltoren ose pozitën e një asamblisti meqenëse dikush nga një subjekt politik është tashmë në opozitë dhe tjetri në pozitë, pra kur është në pyetje siguria e vendit të gjithë duhet të japim kontribut dhe unë besoj që deri më tani siguria në Komunën e Podujevës është e kënaqshme dhe duhet që bashkërisht të punojmë edhe në të ardhmen.

**z.Besim Latifi**, theksoi, besoi që duhet të përmbahemi të gjithë në cilësinë e asamblistit, ta dimë për çka po flasim sepse kemi të bëjmë me një shqetësim dhe koordinim ndër institucional, shqetësimi është që po ndodhin raste dhe ideja është që duhet të ketë koordinim ndër institucional që këto raste mos të na përsëriten, të minimizohen dhe ky duhet të jetë roli jonë si institucione, qoftë si Kuvend, qoftë si Ekzekutiv por edhe organet e sigurisë. Ne krejt çka mundemi është t'i japim mbështetje prej këndit tonë që ato institucione ta kryejnë punën ndershem dhe ligjshem e rastet e tilla të mos na përsëriten, kurse se kush çka ka bërë mund të bëjmë debate gjatë gjithë ditës mirëpo kjo nuk e zgjedh problemin, prandaj besoj se duhet të ekzistoj një formulë që ne të diskutojmë për tema të cilat e shqetësojnë për çdo ditë qytetarin, siç ishte ngritja temës për ujin që ka qenë problem një muaj, pastaj tema tjetër që e ngriti kolegu z.Artrit Mulliqi për këto problemet që po bëhen, kjo mendoj që është në domenin tonë dhe duhet këtu të fokusohemi sa më shumë.

**z.Demokrat Hodolli**, theksoi, e di saktë që nuk është në kompetencën time të japë përgjigje zyrtare por e ndjej një obligim të reagoj duke qenë se jam vetë pjesë e familjes së KRU-Prishtina ku këta po e shfrytëzojnë atë gjë. Është e vërtetë se në Komunën tonë ka pasur reduktime të ujit për një periudhë relativisht të gjatë kohore dhe askush nuk e mohon faktin se uji është element jetik për jetën e përditshme të qytetarëve, megjithatë nuk është me u baltos apo të akuzohet KRU-Prishtina, sikurse është vendosur qëllimisht në rend të dytë Podujeva. Problemet kanë qenë të natyrës objektive dhe natyrore, konkretisht turbullimi i ujit në Liqenin e Batllavës, që ka ndikuar drejtpërdrejtë në furnizim. Fakti që disa komuna tjera kanë pasë furnizim të rregullt të ujit nuk është faktori njerëzor apo neglizhencë pasi që KRU-Prishtina operon edhe me të paktën dy fabrika tjera të cilat prodhojnë ujë njëra është në Shkabaj dhe tjetra në Badofc, prandaj është e pa drejtë që për shkak të problemeve natyrore që kanë prekur Komunën e Podujevës të gjykohet apo të vihet në dyshim puna dhe përkushtimi i KRU-Prishtina e cila ka operuar brenda mundësive teknike dhe kushteve reale që kanë ekzistuar.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, dua t'ju them që për pyetjet që bëhen këtu, përgjigjet duhet të jepen nga drejtorët, jo të ngritën debate duke njëri me tjetrin, nëse ndokush nuk jemi të kënaqur me përgjigjet e drejtorëve, atëherë dikush mund të kërkoj fjalën dhe të parashtroi pyetjen sërish.

**z.Ekrem Rrahmani**, theksoi, unë nuk i parashtrova pyetje kolegut z.Demokrat Hodolli, mirëpo nëse ky po e kundërshton pyetjen time, atëherë kërkoj raportin sa m<sup>3</sup> ujë në sekondë janë prodhuar dhe sa prej tyre kanë shkuar në Prishtinë e sa në Podujevë, pastaj të më demanton mua për këtë.

**znj.Lirie Hoti-Rama**, U.D. drejtoresh e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale DSHMS, theksoi, lidhur me pyetjen e parafolëses për mua, përgjigja është se në QKMF është duke u funksionuar dhe duke ofruar shërbimi i rëntgenit, ndërsa në Urgjencë është lidhur kontrata me operatorin ekonomik dhe jemi në pritje të furnizimit me filma të rëntgenit.

**z.Bahri Selimi**, U.D. drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit-DSHPMSh, si dhe i Autorizuar për kryerjen e funksioneve të Drejtorive tjera për të cilat ende nuk janë emëruar drejtorët/shat, theksoi, i përmbledha të gjitha pyetjet që u bënë sa i përket dikasterit të shërbimeve publike dhe me prioritet po përgjigjem në pyetjen e parë që është bërë e që është shumë e rëndësishme sepse kemi të bëjmë me reduktimin e ujit.

Fillimisht e falënderoj asamblistin z.Demokrat Hodolli i cili e elaboroi pak situatën qysh është në KRU-Prishtina, ne vazhdimisht tërë kohën jemi marrë me këtë problematik sepse ka qenë shqetësim i yni sikurse edhe i juaji edhe pse e dini që kompetencë për këtë çështje është KRU-Prishtina e cila është kompani regjionale, mirëpo ne në asnjë mënyrë nuk kemi heshtur dhe në vazhdimësi jemi marrë me këto probleme që janë adresuar tek ne dhe në bazë të mundësive ne i kemi shtyrë përpara si procese. U cek edhe më herët prej parafolësit që problemi kryesor i reduktimit apo mungesës së ujit në Komunën e Podujevës kohëve të fundit kanë qenë turbullirat në Liqenin e Batllavës dhe kjo i ka pamundësuar fabrikës prodhimin e mjaftueshëm të ujit, apo pastrimin e mjaftueshëm të ujit për territorin e Komunës së Podujevës. Ne përtej angazhimit të pandërprerë, gjatë gjithë kësaj kohe, madje e përmendët që ne para dy ditëve kemi bërë një vizitë në fabrikë dhe kjo ka qenë e organizuar nga ne por aty kanë qenë pjesëmarrës edhe nga KRU-Prishtina dhe na kanë njoftuar saktësisht me statistika dhe punën e problematikat që kanë ndodh.

Tash për herë të parë në Komunën e Podujevës ndodh që në muajin janar të kemi kaq turbullime të ujit dhe arsyeja e kësaj rritja e shpejtë e nivelit të ujit në Liqenin e Batllavës ku brenda 5 ditëve niveli i ujit në Liqenin e Batllavës është rritur 3 metra ndërsa tash në total rritja e nivelit të ujit është 6.5 metër e që kjo i ka krijuar ato turbullime të mëdha ku pastaj fabrika nuk ka pasë mundësi të bëjë pastrimin dhe furnizimin me ujë. Po ashtu gjatë kohës sa ishim në vizitë furnizimi me ujë të pijes për Komunën tonë ka qenë 100 m<sup>3</sup> për sekondë, që nuk është e mjaftueshme, statistikat thonë që Komuna e Podujevës e kërkon që të jenë 160m<sup>3</sup> për sekondë furnizim me ujë që i plotëson nevojat e Komunës, ndërsa sa ishim ne në vizitë furnizimi ka qenë 100m<sup>3</sup> për sekondë për Komunën e Podujevës, kurse deteve të mëparshme ky furnizim ka qenë më i ulët apo në minimumin e furnizimit me ujë të pijes. Krejt kjo i ka shkaktuar reduktimet që kanë qenë të pakontrolluara ndoshta për shkak të pa mundësisë për të caktuar orar sepse ne kemi kërkuar që të përcaktohet edhe orari i reduktimeve për t'i njoftuar qytetarët për orarin e reduktimeve, mirëpo këta nuk kanë mund ta bëjnë një gjë të tillë sepse probleme të mëdha kanë shkaktuar turbullimet dhe kapacitetet të cilat kanë lëvizur kohë pas kohe me furnizim me ujë në Komunën e Podujevës.

U tha se për Komunën e Prishtinës ka pasë furnizim më të madh me ujë kurse në Komunën e Podujevës më pak, kjo nuk qëndron dhe nuk është e vërtetë fare sepse në momentin që ne kemi qenë aty e kemi parë që ne jemi furnizuar me 100m<sup>3</sup> ujë për sekondë ndërsa Komuna e Prishtinës i ka marrë vetëm 180m<sup>3</sup> për sekondë, kjo i bie se nëse krahasojmë numrin e qytetarëve është shumë më e ulët tek ne, dhe nëse e marrim në bazë të përqindjes furnizimi në Prishtinë del të jetë shumë më i ulët se tek ne. Tash pse Prishtina ndoshta ka më pak probleme janë ato që i përmendi parafolësi që Prishtina furnizohet edhe prej dy fabrikave tjera që janë Badofci dhe Shkabaj, por lajmi i mirë është që nga pardje ka filluar të përmirësohet edhe gjendja e ujit në Liqenin e

Batllavës dhe sot është pak më i mirë furnizimi me ujë të pijes të cilin po e përcjellim në vazhdimësi edhe ne dhe po shpresojmë që në ditët në vazhdim nuk do të ketë më reduktime të tilla të gjata ashtu siç ka pasë. Ta keni para sysh se pjesa urbane e qytetit ka qenë më i portretizuar se mundësia për tu furnizuar prej puseve është më e vogël për mos me thënë fare, ndërsa në fshatra që i kanë shprehë shqetësimet e veta ka pasë reduktime më të gjata për shkak këtyre problemeve dhe kanë qenë prioritet i dytë sepse pjesa urbane e ka më të vështirë furnizimin me ujë të pijes.

Një lajm i mirë është prapë që niveli i ujit në Liqenin e Batllavës e siguron pa pasur vërshime apo të reshura të shiut e të borës në këtë nivel kemi ujë për dy vitet e ardhshme me furnizim të mjaftueshëm me kapacitetet që ka sot Liqeni i Batllavës dhe kapacitetet që ka fabrika për përpunimin e ujit në Shajkoc. Një lajm tjetër është se problemet më të mëdha i kemi pasë për ata banorë të cilët jetojnë në Lagjen që njihet “te Radio Llapi” këtë e dimë që aty ka qenë një furnizim pak më i vështirë me ujë, por tani janë bërë disa intervenime së bashku me KRU-Prishtina ku e kemi vendos tashmë gypin e ri dhe ajo lagje do ta ketë tretmanin e njëjtë sikurse pjesa tjetër e qytetit. Jemi duke punuar edhe në segmentin e dytë që përfshinë rrugët “Shakadin Behrami” “Mic Sokoli”, që do të furnizohen me ujë njësoj si lagjja e cekur, dhe nuk do të ketë më probleme të theksuara që i kanë pasë deri më tani sepse problemet më të mëdha kanë qenë aty sigurisht për shkak të nivelit të barabartë të ujit prej nivelit të rezervarit e deri te lagjja e njohur “Lagja e Breçalivës dhe fshati Letanc që kanë më shumë probleme dhe vështirësi për shkak të nivelit të barabartë me rezervarin e ujit e që nuk krijon shtypje të mjaftueshme, madje ka pas raste kur ujë ka pas në pjesën më të ulët si të themi në katin e parë ndërsa nuk ka pas ujë në katet e larta për shkak të mungesës së shtypjes së ujit.

Pyetje pati edhe sa i përket trajtimit të qenve endacak, për ju që nuk keni qenë këtu pjesë e Kuvendit nuk jeni në dijeni, sepse për ata që janë më të vjetër e dinë që unë këtë çështje e kam sqaruar disa herë se cilat janë përgjegjësitë e Komunës për trajtimin e qenve endacak.

Kemi marrë shqetësime dhe tash është rritur numri i qenve endacak duke marrë para sysh se jemi në sezonin dimërore dhe kjo ndodh gjithherë kështu, mirëpo krejt çka mund të bëjë Komuna duke u bazuar në Ligjin e trajtimit të kafshëve, është vetëm trajtimi i tyre, tash ne po mundohemi paksa ta zbusim më shumë atë frikën prej qenve endacak tek fëmijët, mirëpo është e pa mundshme thuajse sepse Ligji i përcakton të gjitha se çka ka mundësi dhe të drejtë Komuna për trajtimin e kafshëve, dhe vetëm po e elaboroj shkurtimisht këtu, do të thotë është kapja e qenit, trajtimi i tij, sterilizimi, vaksinimi, hospitalizimi po që se është e nevojshme dhe në fund çka është e rëndësishme është lëshimi i qenit në vendin e kapjes, ky lëshimi i qenit në vendin e kapjes e len frikën e njëjtë tek banorët edhe pse ai qen është i trajtuar sepse qytetarët nuk e dinë a është trajtuar apo jo por e shohin si qen dhe sigurisht se ju shtohet frika, ne po mundohemi në forma të ndryshme t’i largojmë prej pjesëve ku janë të mbipopulluar qentë mirëpo ta keni të qartë se largimi i të gjithë qenve nga territori i Komunës së Podujevës është i pa mundur dhe nuk është problem vetëm komunal por ky është problem shtetëror që merret edhe shteti me këtë çështje.

Ne kohën e fundit kemi pasë edhe një takim ngase kemi pasë në vazhdimësi diskutim për këtë temë dhe së bashku me Kryetarin e Komunës kemi pasë takim me një organizatë angleze e cila na ka ofruar mbështetje në trajtimin e qenve endacak e që pritet në këto ditë ta nënshkruajmë një Memorandum Bashkëpunimi dhe bashkërisht pastaj të vazhdojmë me trajtimin e qenve jo vetëm endacak por edhe qenve shtëpiak sepse po thuajse janë probleme të njëjta.

Sa i përket pyetjes për sanimin e gropave, pyetja ishte e duhur dhe është kompetencë e DSHPMSh-së, ne tashmë jemi në fazën e kohës dimërore ku mbyllja e gropave është e pa mundshme, por e mira është që e kemi një kontratë dhe është në fazën përfundimtare të lidhjes e cila sigurisht se do e rregulloj këtë problem dhe në momentin që krijohen kushtet atmosferike për

mbylljen e gropave ne do të fillojmë me sanimin e të gjitha gropave. Tash është një numër i madh i gropave ndoshta më shumë në pjesën periferike të qytetit se sa në pjesën e qytetit, kjo ka ndodh për shkak të intervenimeve të KRU-Prishtina, NP-Pastrimi dhe Agjencive tjera të cilat kanë kryer punët e tyre por problemet më të mëdha kanë qenë te KRU-Prishtina që kanë qenë shumë defekte dhe ne sigurisht në asnjë formë nuk e kemi penguar atë të bëjë intervenim në infrastrukturë në mënyrë që qytetarët të kenë ujë të pijshëm.

Sa i përket shkatërrimit të infrastrukturës që e ngriti Artrit Mulliqi, është pjesë e Drejtorisë së Inspeksionit,, përkatësisht kjo është përgjegjësi e inspektorëve dhe e di që kanë shqiptuar gjoba por për këtë mund të japë përgjigje drejtori i DI.

Sa i përket sigurisë në Komunë besoj se u diskutua mjaftë dhe nuk di a mund ta zgjasë më shumë debatin sepse statistikat flasin krejt ndryshe prej asaj që u tha këtu. Ne kemi takime të përditshme me zyrtarët policor por kemi edhe mbledhjet e KKS-së, e që nderuari (Isak Ejupi) e dinë shumë mirë si mbahen ato e qysh raporton policia në mbledhjen e KKS-së, andaj në bazë të statistikave që flasin, Komuna e Podujevës në vitet e fundit del të jetë komuna më e sigurt në gjithë territorin e Republikës së Kosovës, kjo u tha që ka qenë më herët unë po them që është edhe tani dhe e bazoj në statistikat ashtu qysh raportohet në mbledhje të KKS-së se Komuna e Podujevës është komuna më e sigurtë në gjithë territorin e Republikës së Kosovës, ku ndodhin më së paku vrasje, vjedhje e vepra penale që janë të ndaluara me ligjet në fuqi.

Ndërsa lidhur me çështjen e takimit me z.Xhelal Sveçla, ai nuk ka qenë takim politik, nuk ka qenë kërkesë për takim nga një subjekt politik, por ka qenë kërkesë për një takim nga një Ministër i Punëve të Brendshme, prandaj duhet të bëhet dallimi këtu, nuk duhet të thuhet se ka kërkuar takim në cilësinë e përfaqësuesit të subjektit politik sepse kërkesat si subjekt politik në nivel komunal i bënë niveli lokal ndërsa ai është Ministër dhe sigurisht se takimi ka qenë në cilësinë e Ministrit dhe ato që i keni biseduar e dini ju më mirë se ne, por situata aktuale tash e dimë si është, ku është ai e ku jeni ju, ku je ulur ti e ku është ulur ai, prandaj nuk do të doja ta politizojmë shumë atë çështje përderisa situata e sigurisë në Komunën tonë flet krejt ndryshe prej asaj që u tha më herët nga parafolësit. Nuk e di a janë publike të gjitha mbledhjet e KKS-së mirëpo mund t'i përcjellni dhe t'i shihni çfarë statistikash dhe raportimesh bëhen prej Policisë së Kosovës dhe prej FSK-së.

**z.Shuajb Blakçori**, U.D. drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit-DI, theksoi, inspektorët e shërbimeve publike veprojnë në bazë të një Rregulloreje të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Podujevës në mbledhjen e mbajtur më 06.08.2013, me të cilën inspektorët e shërbimeve publike gjatë gjithë aktivitetit të tyre që nga ora 08;00 deri në orën 16;00, dalin në terren gjithashtu i shqyrtojnë gjitha ankesat dhe kërkesat nga qytetarët e Podujevës. Një ndër problemet kryesore që sot e ka Drejtoria e Inspeksionit e në veçanti inspektorët e shërbimeve publike është hovi i madh i ndërtimeve që është duke u bërë në qytetin tonë por edhe gjodat ndaj shkelësve janë të rregullta kështu që mund ta shqiptojmë sot një e gjatë mëngjesit në rrugën "Xhemajl Mustafa", te ndërtimi i lartë në një kompani betonjerkë e cila ka bërë shkelje dëmtrim të rrugës, është shqiptuar një gjobë në vlerë 200€.

Unë apeloj te të gjithë qytetarët që kanë ankesa dhe kërkesa t'i evidentojnë dhe të vijnë në Drejtorinë e Inspeksionit sepse të gjitha shqyrtohen.

**z.Isak Ejupi**, theksoi, faleminderit drejtor i DSHPMSh për sqarimet, mirëpo jo faleminderit për një informatë jo korrekte që ti e din saktësisht që ai nuk ka qenë Ministër i Ministrisë së Punëve të Brendshme, nuk ka qenë periudhë kur ai ka qenë Ministër sepse Ministër ka qenë dikush tjetër por z.Xhelal Sveçla ka qenë Kryetar i Shtabit zgjedhor të LVV-së, dhe ne si institucion e kemi pasë të ndaluar të komunikojmë në kohë fushate me profile të larta të partive politike. Ju them sinqerisht se nuk e kam asnjë problem, dhe i kam thënë se kërkoj mirëkuptim por eja pas zgjedhjeve kur të

duash dera çel është, por në këtë periudhë nuk bënë. Unë e kam zbatuar ligjin por kur dikujt nuk i bie tamam e ka një reagim të tillë, si do qoftë faleminderit.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, ju falënderoj për diskutimet dhe informatat e dhëna.

Për fund lus këshilltarët e Kuvendit që lidhur me e-mailet e dërguara përmes Zyrës së informimit t'i përgjigjeni duke dërguar të dhënat e kërkuara dhe CV-të sepse nevojiten për ueb faqe.

*Meqë nuk pati të lajmëruar për të marrë fjalën, Kryesuesi i Kuvendit e konstatoj të përfunduar këtë mbledhje.*

**Mbledhja përfundoi në orën 12:55**

**Procesverbalin e mbajtën dhe hartuan;**

**Enis Sheholli**

**Osman Bajrami**

**Nr.Prot.01-060/04-0006423/26**

**Podujevë,**

**29 janar 2026**

**Kryesuesi i Kuvendit**

**Isak Shabani**